

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6928
E enjte, 22 qershor 2023
Çmimi 0.40 €

ShBA-ja zgjat emergjencën kombëtare për Ballkanin
Perëndimor | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

NËNSEKRETARJA AMERIKANE VICTORIA NULAND KA TAKUAR TË DËRGUARIN E BE-së PËR DIALOGUN NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË, MIROSLAV LAJÇAK | FAQE 4-5

NULAND: KOSOVA DHE SERBIA T'I ULIN TENSIONET DHE TA ZBATOJNË MARRËVESHJEN E OHRIT



Nënsëkretarja amerikane e shtetit, Victoria Nuland, ka përsëritur kërkesën e ShBA-së drejt Kosovës dhe Serbisë për nisjen e zbatimit të

marrëveshjes së Ohrit, pas një takimi me të dërguarin e BE-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak. Ajo ka

theksuar se ShBA-ja përkrah "planin trepikësh të BE-së si mënyrën më të mirë për ta zgjidhur krizën" në veri të Kosovës

KURTI, SERBËVE NË VERI: NA DUHEN ZGJEDHJE TË REJA ME SHTET LIGJOR | FAQE 5



ARBK-ja SHFUQIZON VENDIMIN, 'KLAN KOSOVA' FALËNDERON AMBASADAT DHE MEDIET PËR MBËSHTETJE | FAQE 3



AKTUALE



UKRAINA: USHTRIA JONË PO AVANCON ME HAPA TË VEGJËL, POR TË SIGURT | F. 2

KONJUFCA KËRKON ANËTARËSIM SA MË TË SHPEJTË TË KOSOVËS NË KËSHILL TË EVROPËS | F. 3

PKD-SË NË PRISHTINË I BASHKOHET ASAMBLISTJA E LV-SË, BERNA SARAÇI | F. 7

EKONOMI



KRYEPROKURORI I SHTETIT DHE ATK-ja DISKUTOJNË PËR PLATFORMËN PËR HETIME PENALE MBI TË DHËNAT INTELIGJENTE | F. 8

KUVENDI SHPENZOI MBI 1 MILION E 600 MIJË EURO NË TRE MUAJT E PARË TË 2023-s | F. 8

SPORT



DRITA 'PESHKON' VIKTORIA PLZENIN NË LIGËN E KONFERENCËS | F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Ukraina: Ushtria jonë po avancon me hapa të vegjël, por të sigurt

KIEV, 21 QERSHOR - Zëvendësministrja e Mbrojtjes e Ukrainës, Hanna Malyar, tha se forcat ukrainase në pjesën jugore të vendit po bëjnë gradualisht përparime, "me hapa të vegjël, por me shumë siguri". Ajo shtoi se trupat ukrainase po e vazhdojnë kundërofensivën sipas planit. "Ne po ecim përpara gradualisht ... dhe ju mund të citoni edhe një alegori se ne po gërryjmë çdo metër tokë nga armiku", tha Malyar, në një vlerësim të bërë më 20 qershor. Ndërkohë, Malyar shkoi në platformën "Telegram" se ka edhe vende ku forcat ruse po përparojnë dhe trupat ukrainase janë në mbrojtje si, për shembull, në qytetet lindore të Ukrainës, Kupyansk dhe Lyman.

Ajo shtoi se "njerëzit duan që të ndodhë si në një film... shumë shpejt", por shtoi se një gjë e tillë nuk mund të ndodhë. "Duhet ta kuptojmë se detyrat që i vendosen ushtrisë kryhen nga ata dhe lëvizja graduale po bëhet në të gjitha drejtimet ku filloi ofensiva. Por, natyrisht, goditja kryesore nuk ka ardhur ende", tha ajo. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha në fjalimin e tij të përnatshëm, se forcat ukrainase "në jug dhe në lindje po e



shkatërrojnë në mënyrë aktive armikun, duke e pastruar fizikisht Ukrainën". Mbrojtja e Ukrainës po "shkatërrohet terroristët", tha ai. "Dhe kjo është një garanci që shteti i së keqes nuk do të ketë kurrë mundësi ta sjellë të keqen në Ukrainë".



Komandanti i forcave tokësore të Ukrainës, gjenerali Oleksandr Syrsky, tha në "Telegram" se trupat e tij po përparonin rreth qytetit lindor të Bahmutit, ndërsa po zbrapsnin sulmet gjithnjë e më intensive ruse pranë Kupyanskut.

Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura raportoi më herët se ushtria ukrainase po e vazhdon ofensivën e saj në zonat e Melitopolit dhe Berdyanskut.

Në verilindje të Ukrainës, trupat ruse e bombarduan kufirin e rajonit Sumy 14 herë, njoftoi administrata ushtarake rajonale. Disa vendbanime u vunë nën zjarr shkaku i 109 shpërthimeve të regjistruara, thuhet në një përmbledhje të administratës ushtarake. Shtëpitë private dhe një fermë u goditën.

Ministria e Mbrojtjes e Rusisë tha se forcat ruse kishin goditur dhe shkatërruar tetë depo municionesh në Ukrainë gjatë 24 orëve të mëparshme. Sipas tyre, forcat ukrainase ishin përpjekur ta sulmonin Donjeckun e kontrolluar nga Rusia dhe rajonin jugor të Zaporizhzhjas, por sulmet ishin zbrapsur.

Forcat ukrainase sulmuan

gjithashtu Nova Kahovkan e kontrolluar nga Rusia, në rajonin jugor të Hersonit, duke vrarë një grua dhe duke plagosur katër civilë, thanë autoritetet lokale të emëruara nga Rusia.

Rusia më 20 qershor nisi një tjetër sulm me raketa, dronë dhe artileri ndaj Kievit dhe disa qyteteve të tjera të Ukrainës, duke vrarë të paktën dy persona, thanë autoritetet rajonale dhe ushtria. Mbrojtja ajrore e kryeqytetit ukrainas zbrapsi një sulm "masiv" rus gjatë natës, duke shkatërruar rreth 20 dronë të prodhuar nga Irani, tha në "Telegram" guvernatori i rajonit të Kievit, Serhiy Popko, duke shtuar se ky ishte sulmi i parë ndaj Kievit në 18 ditët e fundit.

Mbrojtja ajrore e Ukrainës tha se kishte rrëzuar 32 nga gjithsej 35 dronë të prodhuar nga Irani. Rajonet Zaporizhzhja dhe Lviv ishin gjithashtu në shënjestër të sulmeve ruse gjatë natës.

Në Zaporizhzhya sulmi kishte në shënjestër infrastrukturën e komunikimit dhe strehimit, si dhe ndërmarrjet bujqësore, tha shefi i administratës ushtarake rajonale, Yuriy Malashko. Një objektiv i infrastrukturës kyçe

u godit gjithashtu në Lviv, tha guvernatori rajonal Maksym Kozytskiy.

Vala e fundit e sulmeve erdhi pasi Zyra e Komisionarit të Lartë të OKB-së për të Drejtat e Njeriut tha se që nga 18 qershori 9 083 civilë ukrainas janë vrarë dhe 15 779 janë plagosur që nga fillimi i pushtimit të paprovokuar të Ukrainës nga Rusia në shkurt të vitit të kaluar.

Vetëm në qershor 112 civilë u konfirmuan si të vrarë dhe 445 u plagosën, tha OKB-ja në një deklaratë më 19 qershor, duke paralajmëruar se numri real mund të jetë shumë më i lartë.

Shumica e viktimave u vranë nga zjarri i rëndë i artilerisë si dhe nga sulmet me raketa dhe ajrore, tha OKB-ja.

Në frontin diplomatik, kancelari gjerman Olaf Scholz më 20 qershor tha se i kishte bërë thirrje Kinës që ta përdorte më shumë ndikimin e saj mbi Rusinë lidhur me luftën në Ukrainë. Duke folur së bashku me kryeministrin e Kinës, Li Qiang, pas bisedimeve dypalëshe në kryeqytetin gjerman, Scholz tha se Kina nuk duhet ta furnizojë me armë Rusinë.

Kina është partnerja më e madhe ekonomike e Rusisë, e cila është goditur nga sanksionet perëndimore pasi nisi pushtimin e paprovokuar të Ukrainës në shkurt të vitit të kaluar. Vëllimi tregtar midis Pekinit dhe Moskës arriti rekordin prej 190 miliardë dollarësh vitin e kaluar.

Sipas të dhënave doganore të publikuara më 20 qershor, importet kineze të naftës ruse muajin e kaluar arritën nivelin e tyre më të lartë që nga pushtimi i Ukrainës - 9.71 milionë tonë.

Në Bruksel, shefja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, tha se Bashkimi Evropian u kërkoi vendeve anëtare t'i sigurojnë 50 miliardë euro më shumë për ta mbështetur Ukrainën gjatë katër viteve të ardhshme. "Kjo rezervë financiare do të na lejojë me të vërtetë ta kalibrojmë mbështetjen tonë financiare sipas zhvillimit të situatës në terren", tha von der Leyen. /REL

Bideni e quan liderin kinez diktator, Kina e cilëson "provokim të hapur politik"

UASHINGTON, 21 QERSHOR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Joe Biden, e ka quajtur presidentin e Kinës, Xi Jinping, diktator, gjatë pjesëmarrjes në një ngjarje për mbledhje të fondeve në Kaliforni. Kjo deklaratë e presidentit amerikan vjen një ditë pasi sekretari amerikan i Shtetit, Antony Blinken, u

takua me liderin kinez në Pekin për bisedime, që kishin për qëllim lehtësimin e tensioneve midis dy superfuqive të botës. Xi tha se ishte bërë njëfarë përparimi në Pekin, ndërsa Blinken shtoi se të dyja palët ishin të hapura për më shumë bisedime. Ndaj kësaj deklarate ka reaguar zëdhënësja e Ministrisë së

Jashtme, Mao Ning, e cila i ka quajtur komentet e Bidenit "qesharake". "Deklaratat përkatëse nga pala amerikane janë jashtëzakonisht qesharake dhe të papërgjegjshme. Ato cenojnë seriozisht faktet bazike, protokollin diplomatik dhe dinjitetin politik të Kinës. Ato janë një provokim i hapur politik", tha Ning.



ARBK-ja shfuqizon vendimin, 'Klan Kosova' falënderon ambasadat dhe mediet për mbështetje

PRISHTINË, 21 QERSHOR - 'Klan Kosova' ka kënaqësinë të njoftojë se është përmbyllur plotësisht në mënyrë të rregullt dhe ligjore procesi pranë institucioneve të Republikës së Kosovës.

Të mërkurën Agjencia Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve (ARBK) ka lëshuar vendim zyrtar, me të cilin ka njoftuar se përfaqësuesi i autorizuar i Shoqërisë Tregtare 'Klan Kosova Sh.PK.' ka dorëzuar kërkesën për plotësim dokumentacioni dhe se me këtë rast ARBK-ja ka bërë shfuqizimin e vendimit të saj për suspendimin e certifikatës së biznesit.

Me këtë rast, Drejtorja e ARBK-së zyrtarisht ka njoftuar se kështu kanë ndryshuar rrethanat faktike, të cilat kishin nxitur vendimin e

javës së kaluar për pezullimin e certifikatës së biznesit të 'Klan Kosovës', duke dhënë vlerësimin e ri se ai vendim tash është shfuqizuar.

Vendimin e së mërkurës ARBK-ja e ka përcjellë në Komisionin e Pavarur për Media (KPM) dhe në 'Klan Kosova'.

'Klan Kosova' ka bërë shkresë zyrtare drejtuar KPM-së në mënyrë që t'i njoftojë për korrigjimet e bëra dhe vendimin e ri të ARBK-së.

'Klan Kosova' i falënderon të gjithë ata që u angazhuan që ky proces administrativ të shkojë sipas ligjit, që janë ambasadat e Quintit të akredituara në Kosovë, institucionet dhe organizatat ndërkombëtare dhe vendore të të drejtave të njeriut, mediet dhe gazetarët për solidarizimin pa asnjë hezitim.



ShBA-ja zgjat emergjencën kombëtare për Ballkanin Perëndimor

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Shtëpia e Bardhë ka bërë me dije, nëpërmjet një njoftimi, se presidenti i ShBA-së, Joe Biden, ka vendosur ta zgjasë emergjencën kombëtare në lidhje me Ballkanin Perëndimor të paktën deri më 26 qershor të vitit 2024. Kjo emergjencë ishte shpallur me urdhër ekzekutiv më 26 qershor të vitit 2001, por Biden, në një deklaratë të lëshuar më 20 qershor, bëri me dije se ajo do të zgjatet edhe përtej 26 qershorit të këtij viti shkaku i situatës në Ballkanin Perëndimor.

Në njoftimin e Shtëpisë së Bardhë thuhet se "veprimet e personave që kërcënojnë paqen dhe përpjekjet ndërkombëtare për stabilizim në Ballkanin Perëndimor" dhe situata aktuale në këtë rajon "paraqesin një kërcënim të pazakontë dhe të jashtëzakonshëm për sigurinë kombëtare dhe politiken e jashtme të Shteteve të Bashkuara. Për këtë

arsye kam përcaktuar se është e nevojshme të vazhdohet emergjenca kombëtare e shpallur me urdhër ekzekutiv lidhur me Ballkanin Perëndimor", thuhet në mesazhin e Bidenit për Kongresin Amerikan.

Më 8 qershor të vitit 2021 ShBA-ja kishte zgjeruar fushëveprimet e kësaj emergjence kombëtare, pasi që u tha se vendet e ish-Jugosllavisë dhe Shqipëria janë përballur, gjatë dy dekadave të fundit, me korrupsion dhe veprime që pengojnë marrëveshjet e arritura pas luftës. Ndërkohë, më 20 qershor, i dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka theksuar se tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë "potencial të shndërrohen në konflikt rajonal".

Këto deklaratat ai i ka bërë në një debat të zhvilluar nga Këshilli i Atlantikut në Uashington, së bashku me të dërguarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajçak. "Jam shumë i shqetësuar. Kjo

[situata] ka potencial të shndërrohet në konflikt rajonal, në një konfrontim rajonal. Prandaj, ne jemi shumë mbështetës të përpjekjeve evropiane", ka thënë Escobar, duke shtuar se duhet të jetë një përpjekje evropiane. "Këto shtete janë në Evropë. Aspiratat e tyre më të mëdha janë të bëhen pjesë e Evropës dhe përderisa ata i normalizojnë raportet e tyre, ata, po ashtu, harmonizojnë sistemet e tyre me Evropën. Po ashtu, si mbështetësit më të mëdhenj të Kosovës, do të dëshironim ta shihnim atë pjesë të NATO-s, BE-së. Ajo që duam është një proces që adresohen shqetësimet e pesë shteteve mosnjohëse [të BE-së] dhe ky duhet të jetë një proces evropian", shtoi ai.

Tensionet në veri janë rritur që nga 26 maji. Atë ditë serbët nisën protestat kundër hyrjes në ndërtesat komunale të kryetarëve të rinj shqiptarë të Zveçanit, të Zubin Potokut dhe të Leposaviqit, të cilët hynë në ndërtesa me asistimin e Policisë së Kosovës.

Konjufca kërkon anëtarësim sa më të shpejtë të Kosovës në Këshill të Evropës

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Glauk Konjufca, ka zhvilluar një agjendë të pasur takimesh në Strasburg, me udhëheqës të grupeve politike, komiteteve dhe delegacioneve të ndryshme shtetërore në Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE).

Pas takimeve me drejtues të APKE-së, të zhvilluara gjatë paradites së djeshme, kryetari Konjufca është prituri në takime të veçanta nga kryesuesi i Grupit Socialist, Demokrat dhe të Gjellbrit, Frank Schwabe, shoqëruar nga anëtarë të tjerë të delegacionit gjerman, kryesuesi i Grupit të Partive Popullore Evropiane, Aleksander Pocij dhe

kryesuesi i Grupit të të Majtëve Evropianë të Bashkuar (UEL), George Katrougalos.

Po ashtu, kryetari i Kuvendit ka zhvilluar takime me kryesuesin e Komitetit për Çështje Politike dhe Demokraci, Zsolt Nemeth dhe dy delegacione parlamentare në APKE: delegacionin e Mbretërisë së Bashkuar dhe atë Francës.

Në këto takime të përzemërta u diskutua lidhur me proceset politike nëpër të cilat po kalon vendi ynë, sfidat që ka para vetes dhe aspiratat euroatlantike të tij. Konjufca ka potencuar rëndësinë e anëtarësimit sa më të shpejtë të Kosovës në Këshill të Evropës dhe ka kërkuar mbështetjen e grupeve politike dhe të delegacioneve që përfaqësojnë gjatë vlerësimit dhe



procedurave të brendshme. U diskutua edhe lidhur me caktimin e raportuesve për

Kosovën nga Komiteti për Çështje Politike dhe Demokraci, si dhe Komiteti për Çështje Juridike dhe

të Drejta të Njeriut, të cilët do të jenë hartues të raportit për vendin tonë.



NËNSEKRETARJA AMERIKANE VICTORIA NULAND KA TAKUAR TË DËRGUARIN E BE-së PËR DIALOGUN NË MES TË KOSOVËS DHE SERBISË, MIROSLAV LAJČAK

Nuland: Kosova dhe Serbia t'i ulin tensionet dhe ta zbatojnë marrëveshjen e Ohrit

Nënsëkretarja amerikane e shtetit, Victoria Nuland, ka përsëritur kërkesën e ShBA-së drejt Kosovës dhe Serbisë për nisjen e zbatimit të marrëveshjes së Ohrit, pas një takimi me të dërguarin e BE-së për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajčak. Ajo ka theksuar se ShBA-ja përkrah “planin trepikësh të BE-së si mënyrën më të mirë për ta zgjidhur krizën” në veri të Kosovës

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Nënsëkretarja amerikane Victoria Nuland u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë që menjëherë t'i ulin tensionet dhe ta fillojnë zbatimin e marrëveshjes së Ohrit. Nuland ka shkruar në “Twitter”, pas takimit me të dërguarin e Bashkimit Evropian, Miroslav Lajčak, se vazhdojnë ta mbështetin planin trepikësh të BE-së si mënyra më e mirë për zgjedhjen e krizës. “Ne u bëjmë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i zvogëlojnë tensionet menjëherë dhe ta fillojnë zbatimin e angazhimeve të Ohrit. Ne vazhdojmë ta mbështetim planin trepikësh të BE-së si mënyra më e mirë për zgjidhjen e krizës”, ka

shkruar Nuland.

Për takimin me Nuland ka shkruar edhe i dërguari i BE-së, Miroslav Lajčak. “Kisha një bisedë të mirë me nënsëkretaren Victoria Nuland. Kemi ndarë të njëjtin vlerësim rreth situatës në veri të Kosovës dhe rrugën për të dalë nga kjo situatë. U pajtuam që të një rëndësie të menjëhershme janë deeskalimi dhe rikthimi në dialogun e lehtësuar nga BE-ja”, ka shkruar Lajčak në “Twitter”. Sipas planit trepikësh të BE-së, kryetarët në Leposaviq dhe Mitrovicë të Veriut të veprojnë njëjtë si ata të Zveçanit dhe Zubin Potokut e të punojnë nga zyra alternative, njësitet speciale të zhvendosen nga afërsitë e ndërtesave komunale dhe të shpallen zgjedhje të reja në veri sa më parë.

Një ditë më parë i dërguari i Uashingtonit për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, ka thënë se tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë kanë “potencial të shndërrohen në konflikt rajonal”. Këto deklarata ai i ka bërë në një debat të zhvilluar nga Këshilli i Atlantikut në Uashington, së bashku me të dërguarin e BE-së për dialogun, Miroslav Lajčak. Ky i fundit ka thënë se nëse nuk arrijnë ta shtensionojnë situatën do të ketë viktima. Escobari u pyet edhe për akuzat se ShBA-ja dhe BE-ja janë të buta ndaj Serbisë dhe të ashpra me Kosovën. Por, zyrtari amerikan tha se për 15 vjet çdo gjë që ka bërë Uashingtoni ka qenë në favor të Kosovës. Edhe Parlamenti Evropian u ka bërë thirrje Kosovës dhe Serbisë t'i

ulin tensionet në kohën kur i gjithë kontinenti evropian po kalon nëpër një situatë të ndjeshme. Këto thirrje u bënë nga presidentja e PE-së, Roberta Metsola, gjatë vizitës në Kroaci për shënimin e 10-vjetorit të anëtarësimit të Zagrebit në Bashkimin Evropian. Metsola ka theksuar se agresioni i Rusisë kundër Ukrainës është një dëshmi se sa kanë ndryshuar rrethanat sot në Evropë dhe me çfarë sfidash po përballet kontinenti. “Ne si Parlament Evropian u kemi bërë thirrje Serbisë dhe Kosovës ta shtensionojnë situatën. Shtensionimi është fjala kyçe këtu. Nuk mund të shohim më shumë dhunë në kohën kur kontinenti ynë është aq i ndjeshëm”, ka thënë Metsola. Kosova dhe Serbia arritën marrëveshje drejt normalizimit të raporteve më 27 shkurt në Bruksel si dhe u pajtuan për Aneksin e zbatimit të saj në Ohër më 18 mars. Edhe marrëveshja e Ohrit kërkon që palët t'i zbatojnë të gjitha

marrëveshjet e arritura deri më tani në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve, përfshirë edhe atë për formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë. Por, situata në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe - është tensionuar që nga 26 maji, kur Policia e Kosovës asistoi kryetarët e rinj shqiptarë të Zveçanit, Leposaviqit e Zubin Potokut, të hynin në ndërtesat komunale. Serbët lokalë kanë protestuar që nga ajo ditë. Komuniteti ndërkombëtar i ka shprehur tri kërkesa për kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, lidhur me situatën në veri: shtensionimin e situatës atje, mbajtjen e zgjedhjeve të reja dhe kthimin në dialogun për normalizimin e marrëdhënieve Kosovë - Serbi të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian. Kurti, në anën tjetër, e ka prezantuar ditë më parë një plan pesëpikësh për ulje të tensioneve. “1. Sundimi i ligjit në katër komunat në veri, që nënkupton identifikimin, ndjekjen penale

Kurti, serbëve në veri: Na duhen zgjedhje të reja me shtet ligjor

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka vlerësuar se zhvillimi i zgjedhjeve të parakohshme në komunat në veri të Kosovës është i nevojshëm, por me një fushatë të lirë parazgjedhore. Ai theksoi se për ta realizuar një gjë të tillë nevojitet shtet ligjor. "Pra, një mjedis ku nuk ka frikë dhe kriminelë. Kjo është ajo që ne duam dhe duhet ta arrijmë së bashku", ka thënë Kurti në një videofjalim drejtuar komunitetit serb në gjuhën e tij amtare.

Ai tha se "me sundimin e ligjit, gradualisht mund ta zvogëlojmë numrin e policëve në ndërtesat komunale". "Përfaqësuesit e Listës Serbe, sikur edhe Jabllanoviqi, kanë thënë gjithfarë gjërash për Kosovën dhe për mua, por unë kam mbetur i gatshëm t'i pranoj si kryetarë të ardhshëm komunash. Fatkeqësisht, nuk kam as fuqi e as vullnet që t'i

detyroj të kandidojnë në zgjedhje. Tani kryetar i komunës është Lulzim Hetemi derisa të zgjedhet një i ri. Për këtë na duhen zgjedhje të parakohshme dhe një fushatë parazgjedhore e hapur, e lirë, në katër komunat në veri. Pa një fushatë të ndershme dhe demokratike nuk ka zgjedhje të ndershme dhe demokratike. Prandaj në radhë të parë nevojitet sundimi i ligjit, pra një mjedis ku nuk ka frikësim dhe kriminelë. Këtë duam dhe duhemi ta vendosim së bashku. Me sundimin e ligjit, gradualisht mund ta zvogëlojmë numrin e policëve në ndërtesat komunale", ka deklaruar Kurti. Më 26 maj Policia e Kosovës asistoi në hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në ndërtesat komunale në Zveçan, Leposaviq dhe Zubin Potok, gjë që u kundërshtua ashpër nga popullata serbe, e cila është shumicë në atë rajon. Në ato

objekte punojnë edhe komunat paralele sipas sistemit serb, të cilat janë ilegale për Kosovën.

Serbët lokalë në veri të Kosovës i kishin bojkotuar zgjedhjet e prillit dhe tani nuk i pranojnë rezultatet e tyre.

Që nga 29 maji ata kanë protestuar çdo ditë me kërkesat që kryetarët shqiptarë të mos dalin në punë dhe të tërhiqen tërësisht njësitë speciale të Policisë së Kosovës nga veriu.

Ndërkohë, komuniteti ndërkombëtar u ka kërkuar Prishtinës dhe Beogradit shtensionim të menjëhershëm të situatës në veri dhe kthim në dialog për normalizimin e marrëdhënieve.

Në fjalimin e tij drejtuar serbëve në veri, kryeministri Kurti tha se është e nevojshme që në të ardhmen "të zbatohet plotësisht dhe pa kushte marrëveshja bazë e Brukselit, pjesë përbërëse e së cilës është edhe Aneksi i Ohrit".

Në fund të shkurtit Kosova dhe Serbia arritën marrëveshjen për normalizimin e marrëdhënieve në bazë të propozimit të BE-së dhe në mars u pajtuan për aneksin për zbatimin e saj. Ndër të tjera, kjo marrëveshje parasheh që Kosova t'u sigurojë pjesëtarëve të komunitetit serb një nivel të caktuar të vetëmenaxhimit, ndërsa Serbia nuk duhet ta cenojë integritetin territorial të Kosovës.

Kurti i akuzoi autoritetet në Beograd dhe Partinë Progresive Serbe për "politizimin e kriminelëve" dhe tha se Kosova po e lufton korrupsionin. "Të ecim së bashku drejt një të ardhmeje më të mirë, duke ndërtuar ura të forta, shkaku i asaj që duam për veten dhe familjet tona. Shtëpia është shtëpi. Vendi ynë është shtëpia e të gjithë neve", ka thënë Kurti, duke theksuar se nuk dëshiron luftë. "Sulmi dhe kidnapimi i

policëve, gjuajtja ndaj ushtarëve të KFOR-it, sulmet e dhunshme ndaj gazetarëve nuk do të tolerohen. Një shoqëri demokratike dhe liberale nuk duron dot kulturën e të dhunshmëve. Aleksandër Vuçiq sot përfaqëson gatishmërinë e Serbisë për të humbur edhe një luftë. Në të njëjtën kohë, ai është garancia juaj që vitet '90 nuk do të bëhen të kaluara. Unë nuk jam për luftë. Unë jam kundër luftës. Unë jam socialdemokrat. Kam vuajtur gjatë luftës, kam qenë i burgosur lufte për më shumë se dy vjet e gjysmë. Ai duket se ka vetëm kujtime të mira nga lufta dhe ndjenja të tilla, sepse edhe atëherë ishte në pushtet si ministër i Millosheviqit dhe, ndryshe nga sot, ai kishte pushtet madje pa detyrime, sepse të gjithë përgjegjësinë e mbante Millosheviq", ka thënë Kurti.



dhe gjykimin e drejtë të të gjithë anëtarëve të grupeve kriminale që kanë sulmuar Policinë, trupat e NATO-s dhe gazetarët; 2. Grupet e dhunshme të tërhiqen menjëherë nga territori i Kosovës dhe ndalohet çdo akt kriminal kundër institucioneve të Kosovës; 3. Policia e Kosovës, pjesëtarë të NATO-s dhe EULEX-i të kryejnë vlerësime të përbashkëta të sigurisë, për të garantuar një ambient të sigurt dhe pa rreziqe për të gjithë; 4. Qeveria e Kosovës të koordinohet me të gjithë aktorët dhe të shpallë zgjedhje të parakohshme në katër komunat në veri; dhe 5. Kosova dhe Serbia t'i rikthehen dialogut të ndërmjetësuar nga Brukseli, dhe një takim i nivelit të lartë të mbahet gjatë kësaj jave", thuhet në planin pesëpikësh të Kurtit.

BE-ja: Nuk kemi konfirmim për takimin Kurti - Vuçiq, presim përgjigje pozitive

Zëdhënësi i Bashkimit Evropian, Peter Stano, ka thënë se BE-ja nuk ka ende përgjigje nga kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, dhe presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, për ftesën për një takim këtë javë në Bruksel. "Ne kemi thënë mjaft sa iu përket pritjeve tona, pasojave të mundshme dhe hapave. Çështja kryesore është të kemi takim këtu në Bruksel dhe rreth kësaj, në këtë moment, nuk kam asgjë për të saktësuar", ka theksuar Stano në një konferencë për

medie. Megjithatë, Stano shtoi se "deri në fund të javës ka akoma kohë", por se nuk mund të konfirmojë ndonjë datë apo kohë për takimin e ftuar nga përfaqësuesi i lartë për politikë të jashtme dhe siguri, Josep Borrell. "Po presim dhe shpresojmë se mund ta kemi datën dhe kohën e takimit dhe t'i diskutojmë pastaj modalitetet. Nuk kemi kohë për të humbur. Është koha për veprime, jo për fjalë dhe spekulime", ka deklaruar Stano.



Vazhdon projekti për efijencë të energjisë edhe në ndërtesat shumëbanesore sociale në Drenas

DRENAS, 21 QERSHOR - Pas marrëveshjeve për efijencë të energjisë në disa shkolla të komunës së Drenasit, projekti për Efijencë të Energjisë (FKEE) do ta vazhdojë zbatimin edhe në ndërtesat shumëbanesore sociale në komunën e Drenasit. Në kuadër të këtij projekti janë

përzgjedhur përfaqësuesit e njësive banesore të cilët do ta bëjnë organizimin dhe përfaqësimin e banorëve të këtyre ndërtesave. Kjo përzgjedhje ka bërë që projekti në fjalë të kalojë në procesin e përgatitjes për implementim nga i cili do të përfitojnë banorët e këtyre ndërtesave

sociale. Kryetari Lladrovci muaj më parë kishte takuar drejtorin menaxhues të Fondit të Kosovës për Efijencë të Energjisë (FKEE), Ahmet Ismajli, me të cilin kishte nënshkruar edhe pesë marrëveshje të reja të shërbimeve të energjisë.



Në qytetin e Gjilanit do të instalohen edhe 257 kamera të sigurisë

GJILAN, 21 QERSHOR - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS) e ka vlerësuar stabile gjendjen e sigurisë në Gjilan në një takim në të cilin është diskutuar edhe për aktivitetet parandaluese të dukurive negative përmes instalimit të kamerave. Po ashtu, KKS-ja ka diskutuar edhe për pritjen e bashkatdhetarëve, gjithashtu po në këtë takim janë lansuar edhe fushatat vetëdijesuese kundër ndezjes së zjarreve fushore dhe malore, përkatësisht fushatës për parandalimin e të shtënave festive. Bejtullah Osmani, koordinator i KKS-së, ka thënë se gjithçka është gati për t'i filluar vizitat në terren dhe paraqitjen e materialeve vetëdijesuese sa i përket rrezikut nga zjarret fushore dhe malore, ndezja e të cilave, pos që është e dëmshme, është edhe e dënueshme me kodin penal të Republikës së Kosovës.

Kurse sa i përket pritjes së bashkatdhetarëve, Osmani ka thënë se komuna do t'i ndërmarrë masat e duhura që kërkesat e tyre t'i trajtojnë me prioritet, ndërkaq

për shkeljet eventuale nga ana e tyre duhet të jenë të vetëdijshëm se edhe ata do t'i nënshtrohen ligjit sikurse të gjithë qytetarët e tjerë.

Sa i përket zgjerimit të rrjetit të kamerave në qytet, në funksion të rritjes së sigurisë, Osmani ka thënë se pritet të shtohen edhe 257 kamera, një projekt ky që mbështetet nga Ambasada e ShBA-së në Kosovë. Aktualisht janë funksionale 96 kamera. Sipas policisë, këto pajisje po e lehtësojnë punën e tyre për zbulimin e kryesve të veprave penale, por ky rrjet duhet të shtrihet edhe në lokacione të tjera, sikurse ka nevojë të ndërrohet sistemi i kamerave ekzistuese për t'u zëvendësuar me kamera të reja që kanë rezolucion më të madh. Aktualisht janë identifikuar edhe lokacionet ku duhet të vendosen kamerat e sigurisë. Sipas projekcionit, gjithsej 291 lokacione në qytetin e Gjilanit do të monitorohen nga kamerat e sigurisë.

Sa i përket fushatës kundër të shtënave me armë të zjarrit gjatë ahengjeve dhe tubimeve



familjare, zëvendësministri i MPB-së, Blerim Gashani, ka thënë se këto të shtëna jo vetëm që prishin gjendjen e sigurisë publike, por shpeshherë rezultojnë edhe fatale, andaj u ka bërë thirrje qytetarëve të festojnë me zemër dhe jo me armë.

“Qëllimi ynë është që edhe përmes kësaj fushate të kontribuojmë për krijimin e një mjedisi të sigurt për të gjithë qytetarët tanë”, ka thënë Gashani. Ai ka rikujtuar se të shtënat me armë zjarri gjatë ahengjeve festive janë të ndaluara me ligj, sepse

paraqesin kërcënim për jetën e njeriut dhe për sigurinë publike. Mentor Cakolli (UNDP), mbështetës i projektit, ka thënë se qëllimi i fushatës ‘festo me zemër, jo me armë’ është që mesazhi kundër të shtënave festive të përcillet te secili qytetar.

Një delegacion turk viziton komunën e Mitrovicës, interesohet për investime në fushën e agroekonomisë



MITROVICË, 21 QERSHOR - Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Mitrovicës, Vesa Broja, së bashku me drejtorin për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, Ferdi Kadriu, kanë pritur në takim delegacionin turk në krye me kryetarin e Platformës të Shoqatave, Mehmet Aydogan, kryetarin e Federacionit Ndërkombëtar të “Giritler”, Zafer Yusuf Guzelkasap, kryetarin e degës të Ballkanit të Platformës së Shoqatave, Mustafa Ulu dhe pronarin e firmës “Agronom”,

Abdurrahman Doruk. Gjatë këtij takimi delegacioni turk ka shprehur interesimin për të realizuar investime në fushën e agroekonomisë dhe mbështetjen e grave ndërmarrëse. Kryesuesja Broja i falënderoi për vizitën dhe gatishmërinë duke i premtuar bashkëpunim për projekte në vazhdim. Drejtori Kadriu ka folur edhe për gjendjen e bujqësisë dhe e ka njoftuar delegacionin turk për potencialet bujqësore që i ka komuna e Mitrovicës.

Shpërndahen 14 motokultivatorë me frezë, kosë dhe rimorkio në Podujevë

Podujevë, 21 qershor - Janë shpërndarë 14 motokultivatorë me frezë, kosë dhe rimorkio për 14 fermerët përfitues nga projekti që është bashkë-financuar nga komuna e Podujevës dhe organizata “Qatar Charity”. Në procesin e shpërndarjes së

mekanizmit bujqësor ka marrë pjesë drejtori i Bujqësisë, Fatmir Rudari, i cili i ka uruar të gjithë fermerët përfitues nga ky projekt dhe është zotuar para tyre se mbështetja në sektorin e bujqësisë për fermerët e vyer do të rritet. Drejtori Rudari ka falënderuar

edhe organizatën nga Katari për bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me komunën e Podujevës në shumë sektorë, veçanërisht për ndihmën që po e ofron në sektorin e bujqësisë për blerjen e mjeteve të punës për fermerët llapjanë.



Mbi 500 banorë të Llapushnikut përfitojnë nga rrjeti i ri elektrik

PRISHTINË, 21 QERSHOR - KEDS-i ka shtuar ritmin e investimeve anekënd Kosovës. Në Llapushnik, lokalitet ky i shtrirë në pjesën qendrore të vendit, është instaluar rrjeti elektrik i ri i tensionit të mesëm dhe i atij të ulët. Fitim Prokshi, mbikëqyrës i projekteve dhe inxhinier në KEDS, ka thënë se me instalimin e rrjetit të ri, ku përfshihen tre transformatorë, mbi 14 000m përçues elektririkë dhe rreth 230 shtylla të profileve të ndryshme, kanë përfituar më shumë se 200 familje. "Me instalimin e këtij rrjeti të ri elektrik konsumatorët tanë në këto

lagje të Llapushnikut tashmë kanë furnizim të qëndrueshëm me energji elektrike dhe siguri", është shprehur ai. Ky investim, që është lëshuar në punë ditët e fundit, ka dhënë efektet e veta menjëherë, duke sjellë shërbime më kualitative. Banorët e këtyre lagjeve shprehen të kënaqur me rrjetin e ri elektrik. Bajram Gashi, banor i lagjes Gashi, falënderon KEDS-in që rrjetin e vjetër elektrik e zëvendësoi me të riun. "Unë jam kthyer prej Gjermanisë në vitin 2011. Jam pensionist atje! Atëherë nuk e kemi pasur gjendjen e

mirë me furnizim me energji elektrike. Që nga dhjetë ditë jemi lidhur me rrjet të ri dhe jemi shumë të kënaqur", u shpreh ai. Edhe Avdi Gashi, ish-profesor në shkollën e mesme të Drenasit, e vlerëson punën e KEDS-it shumë të nevojshme për fshatin ku jeton, duke përcuar edhe një mesazh të tjerët. "Kemi pasur shtylla të vjetra. Tash kemi tension stabil dhe kreu aparatat na funksionojnë ashtu siç duhet. Me instalimin e këtij rrjeti uroj që edhe njerëzit të vetëdijesohen dhe të mos e keqpërdorin energjinë elektrike", ka theksuar ai.



Projekti i rrjetit të ri elektrik i tensionit të mesëm dhe të ulët në këto tri lagje kap një vlerë prej mbi 120 mijë eurosh. KEDS-i është në përfundim e

sipër edhe të një projekti tjetër në dy lagje të tjera të Llapushnikut, nga i cili projekt do të përfitojnë mbi njëqind konsumatorë të tjerë.

ShBA-ja fut në listë të zezë kryetarin e Strugës, Ramiz Merko



SHKUP, 21 QERSHOR - Shtetet e Bashkuara e kanë vendosur kryetarin e komunës së Strugës, Ramiz Merkon, në listën e personave që u ndalohet hyrja në ShBA për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion të konsiderueshëm, është thënë në njoftimin e Departamentit Amerikan të Shtetit. "Merko shpërdoroi fondet dhe ndërhyri në proceset gjyqësore dhe të tjera publike, duke dëmtuar besimin e publikut në institucionet dhe zyrtarët

demokratikë të Maqedonisë së Veriut", është thënë në komunikatë. Ramiz Merko është në krye të komunës së Strugës për 14 vjet me radhë si kuadër i Bashkimit Demokratik për Integritim (BDI) që drejtohet nga Ali Ahmeti. Kjo parti është pjesë e Qeverisë së Maqedonisë së Veriut që nga viti 2002, me përjashtim të viteve 2006-2008. "Veprimi i sotëm përçon mesazhin se Shtetet e Bashkuara qëndrojnë me Maqedoninë e Veriut për ta

nxitur stabilitetin përmes forcimit të institucioneve demokratike dhe adresimit të mangësive të sundimit të ligjit. Ky vendim rikonfirmon angazhimin e Shteteve të Bashkuara për ta luftuar korrupsionin, i cili dëmton interesin publik, pengon prosperitetin ekonomik të vendeve dhe pakëson aftësinë e qeverive për t'iu përgjigjur në mënyrë efektive nevojave të njerëzve të tyre", ka thënë Departamenti Amerikan i

Shtetit. Në vendimin e DASH-it përfshihen edhe bashkëshortja dhe tre fëmijët e Merkos, të cilëve, po ashtu, u ndalohet hyrja në ShBA. Merko ka qenë në shënjestër të kritikave për shpërdorim të fondeve, në shumë raporte të Entit të Revizionit të Maqedonisë së Veriut. Vetëm gjatë vitit 2022 ai ka ndarë nga buxheti i komunës 80 000 euro për dhurata, dreka e darka. Komisioni Shtetëror për

Parandalimin e Korrupsionit kishte iniciuar një procedurë kundër Merkos për shpërdorim të detyrës, në rastin e furnizimit të komunës me katër automjete në vlerë prej 114 000 eurove, prej të cilave, njëra për vetë Merkon, në vlerë prej 67 000 eurove, por hetimi kundër tij nuk është proceduar. Merko ishte edhe në epiqendër të kritikave të shoqatave për mbrojtjen e kafshëve për shkak të qëndrimit të tij për vrasjen masive të qenve endacakë.

PDK-së në Prishtinë i bashkohet asamblistja e LV-së, Berna Saraçi

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Nënkryetarja e komunës së Prishtinës nga radhët e PDK-së, Donjeta Sahatçiu, ka njoftuar të mërkurën se PDK-së i është bashkuar asamblistja nga Lëvizja Vetëvendosje, Berna Saraçi. Sahatçiu ka thënë se Prishtina i bëri bashkë në qeverisje

fillimisht për projekte konkrete në arsim, shërbime publike, zhvillim rural, kulturë dhe sport. "Ndiheh jashtëzakonisht e plotësuar të shoh se si vizioni 'Prishtina na bashkon' po jetësohet natyrshëm e me vullnet çdo ditë e më shumë. Prishtina na bëri bashkë në qeverisje

fillimisht për projekte konkrete në arsim, shërbime publike, zhvillim rural, kulturë e sport, por që më pas u zgjerua në një frymë që veçse po lulëzon. Bashkë, pa fjalë shumë, me punë dhe përkushtim të sinqertë - ashtu sikurse edhe e kishim dëshiruar nga fillimi", ka shkruar Sahatçiu në "Facebook".



Murati: Brenda këtij muaji do të miratohet Projektligji i ri për skemat pensionale

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka bërë me dije të mërkurën se brenda muajit qershor do të miratohet Projektligji i ri për skemat pensionale bazuar në

vendimin e Gjykatës Kushtetuese për njohjen e kontributit të punëtorëve të larguar nga puna në vitet 1990.

Murati në mbledhjen e Komisionit për Buxhet, Financa dhe Transfere ka

thënë se janë afër finalizimit të miratimit të këtij projektligji dhe se pret që ai të hyjë në fuqi para 15 korrikut, afat ky i vendosur nga Kushtetuesja. Të njëjtin e mirëpritën edhe deputetët, anëtarë të këtij komisioni.



Kryeprokurori i Shtetit dhe ATK-ja diskutojnë për platformën për hetime penale mbi të dhënat inteligjente



Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Administrata Tatimore e Kosovës kanë diskutuar me institucionet e tjera ligjzbatuese për bashkëveprimin në shkëmbim të informatave për platformën për hetime penale mbi të dhënat inteligjente

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, përkatësisht ushtruesi i detyrës i Kryeprokurorit të Shtetit, Besim Kelmendi, së bashku me drejtorin e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), Ilir Murtezaj, mbështetur nga Zyra e UNDP-

së në Kosovë, përmes projektit Saek III, kanë mbajtur takimin e radhës me aktorët institucionalë të zbatimit të ligjit në Republikën e Kosovës. Ata kanë diskutuar për bashkëveprimin e shkëmbimit të informatave për platformën për hetime penale mbi të dhënat inteligjente, si dhe mundësinë e hartimit dhe nënshkrimit të

një marrëveshjeje mirëkuptimi ndërinstitucionale në të ardhmen, me qëllim të mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të cilat do të jenë në shërbim të kësaj platforme. Përveç diskutimeve të bartësve të institucioneve lidhur me aktivitetet bashkëvepruese, përkatësisht materializimin e kësaj platforme, edhe zyrtarët përgjegjës të institucioneve përkatëse të sektorit të teknologjisë informative kanë bërë prezantimin e llojit të të dhënave që prodhon apo përpunon institucioni, formatin dhe hostimin, si dhe mundësitë teknologjike të shkëmbimit të këtyre të dhënave nga secili institucion. Platforma elektronike për

hetime penale mbi të dhënat inteligjente mundëson shkëmbim e informatave që gjenden në databazat e institucioneve zbatuese të ligjit në mënyrë që të përshpejtohen procedurat hetimore për subjektet në rastet e korrupsionit, krimin të organizuar dhe krimin financiar, që do të mundësonte luftimin efikas dhe efektiv të veprave penale, e cila platformë derivon nga marrëveshja bazë ndërmjet Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Administratës Tatimore të Kosovës (ATK). Kjo platformë elektronike ka për synim ndikimin pozitiv në zvogëlimin e nivelit të korrupsionit në Kosovë, duke forcuar mekanizmat e

monitorimit dhe mbikëqyrjes së institucioneve për ta kryer funksionin e tyre në mënyrë efikase, transparente dhe të përgjegjshme.

Në këtë takim, përveç ZKPSH-së dhe ATK-së si bartëse të këtij aktiviteti, kanë marrë pjesë udhëheqës të institucioneve publike nga: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), Ministria e Drejtësisë, Banka Qendrore e Kosovës (BQK), Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Dogana e Kosovës, Njësi i Inteljencës Financiare, Agjencia e Regjistrimit Civil, Agjencia për Informim dhe Privatësi dhe Departamenti i Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave.

Kuvendi shpenzoi mbi 1 milion e 600 mijë euro në tre muajt e parë të 2023-s

PRISHTINË, 21 QERSHOR - Kuvendi i Kosovës ka shpenzuar mbi 1 milion e 600 mijë euro në tre muajt e parë të vitit 2023. Pjesa më e madhe e tyre është për paga dhe shtesa për deputetët, administratën dhe stafin mbështetës, ndërsa rreth 200

mijë euro janë për mallra dhe shërbime. Këto të dhëna janë bërë publike të mërkurën nga zëvendësuesi i sekretarit të Kuvendit, Arben Loshi, në mbledhjen e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Po në këtë mbledhje ky komision ka miratuar edhe

raportet e komisioneve kryesore për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficentit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore.



Salvator Mundi: Misteret e pikturës më të kushtueshme sot në botë

Salvator Mundi, një pikturë që i atribuohet artistit të njohur italian Leonardo da Vinçi, ka tërhequr vëmendjen por edhe ka nxitur shumë polemika në botën e artit. Kjo kryevepër, që përshkruan Jezu Krishtin si Shpëtimtarin e Botës, ka një histori të trazuar dhe është rrethuar nga debate mbi originalitetin, pronësinë dhe vlerën e saj.

Leonardo da Vinçi, një polimat dhe një nga artistët më të mëdhenj në histori, krijoi kryevepra të shumta, përfshirë të famshmen Mona Lisa. Salvator Mundi, besohet të jetë pikturuar nga da Vinci rreth vitit 1500, gjatë kulmit të Rilindjes Italiane.

Piktura tregon aftësinë e tij të pashembullt në kapjen e detajeve të ndërlikuara dhe në përcjelljen e një ndjenje të qetësisë hyjnore. Salvator Mundi, u humb për shekuj me radhë dhe u rishfaq në fillim të shekullit XX-të. Ai iu atribuua gabimisht një artisti tjetër dhe u shit për një shumë modeste.

Ndërkohë në vitin 2005, piktura u ble në një ankand si vepër e një fansi të madh të Leonardo da

Vinçit. Megjithatë, pas restaurimit dhe analizave të shumta, ekspertët nisën të dallojnë ngjashmërinë e tij me stilin e da Vinçit, duke ndezur një debat mbarëbotëror rreth originalitetit të tij.

Ndërsa disa besojnë se është Vinçi autori i tablosë, të tjerë argumentojnë se vepra është fryt një bashkëpunimi ose një punë e studios së tij. Pas rizbulimit të tij, Salvator Mundi, ndërroi duar disa herë. Në vitin 2013, ajo u ble nga miliarderi rus, Dimitri Ribolovlev, për shumën marramendëse 127.5 milionë dollarë.

Kjo shitje me një shumë rekord, e katapultoi pikturën në qendër të vëmendjes dhe ngriti pikëpyetje rreth vlerës së saj të vërtetë. Pronësia e dyshimtë e Salvator Mundi, gjeneroi një seri mosmarrëveshesh ligjore, me akuzat për mashtrim.

Në vitin 2017, Salvator Mundi u rinxor në ankand në Christie's, dhe arriti vlerën befasuese prej 450.3 milionë dollarë, duke e bërë atë pikturën më të shtrenjtë të shitur ndonjëherë. Kjo shitje pushtoi tituj e mediave në mbarë botën dhe ringjalli debate rreth



vlerës së vërtetë të veprës së artit. Çmimi astronomik ngriti gjithashtu pyetje në lidhje me ndikimin e komercializimit në botën e artit dhe rolin e artit si

investim. Shikimi enigmatik dhe gjesti simbolik i Salvator Mundi, i mahnit shikuesit me vështrimin depërtues të Krishtit dhe gjestin e tij bekimi. Këta elementë bartin

një simbolikë të thellë dhe ftojnë gjithëkënd në bërjen e interpretimeve rreth spiritualitetit, hyjnisë dhe rolit të besimit në art.

Shkrimtari disident: Kina ime e ka tejkaluar profecinë e Orwell, tani njerëzit atje janë shndërruar në makina

Nga Monica Ricci
SARGENTINI
"Corriere della Sera"

"Kur u burgosa në Kinë, sepse doja të kujtoja masakrën e Sheshin Tiananmen, preka Ferrin në tokë, dhe tentova 2 herë vetëvrasjen. Por pastaj e kuptova se isha dëshmitar i historisë, ndaj nisa të mbledh historitë personale të të burgosurit që ishin me mua në burg".

Liao Yiwu mban në dorë një copë letër me shkronja kineze, të cilat aq të vogla sa janë thuajse të palexueshme. "Për të shkruar përdorja letër higjienike, dhe nuk kisha shumë"- shpjegon ai. Shkrimtari kinez, që jeton në Berlin të Gjermanisë që prej vitit 2011, është një halë në sy për Republikën Popullore të Xi Jinping për shkak të librave të tij që denoncojnë krimet e regjimit komunist, dhe për të cilët ai ka fituar çmime të shumta letrare.

Liao është në Caorle këto ditë për të marrë çmimin "Luigi Amicone 2023", kushtuar themeluesit dhe ish-drejtorit të "Tempi", që u jepet njerëzve që kanë guximin "t'i etiketojnë gjërat me emrin që kanë". Të shkruarit u bë misioni i tij kryesor në jetë.

I liruar nga burgu në vitin 1994, u nda nga bashkëshortja dhe vajza e tij për t'i shpëtuar persekutimit, ai jetoi si një i pastrehë duke u sjellë vërdallë nëpër rrugët e vendlindjes së tij Chengdu në Sichuan, ku nisi të mblidhte histori disidentësh. Por policia e vëzhgonte.

"Më sekuestruan dorëshkrimet, ndaj u detyrova t'ia filloja nga e



para. Më është dashur ta rishkruaj 3 herë librin, në të cilin tregoj tmerrret që kam përjetuar në burg. Ata nuk donin që ai të botohej. Pastaj erdhën kompjuterët, dhe unë i ruajta gjërat"- tregon ai teksa pi një gotë birrë, si për t'i larguar nga vetja ato kujtime të hidhura.

Yiwu i kritikon shkrimtarët e tjerë kinezë, si për shembull fituesin e Çmimit Nobel në Letërsi Mo Yan, se janë oportunistë dhe nuk mbajnë anë. "Kjo është arsyeja pse ata nuk kanë përfunduar asnjëherë në burg. Vetëm kur dikush vuan atë që kam përjetuar unë, e kupton se ata duan realisht të të asgjësojnë dhe të fshijnë nga

faqja e dheut. Dhe prandaj ti detyrohesh të luftosh"- thekson ai. Kur i them se ceremonia e marrjes së çmimit të tij ndodh në ditën kur Sekretari Amerikan i Shtetit Anthony Blinken po viziton Kinën, ai hap krahët: "Çfarëdo që t'i thonë, nuk është e sigurt se do ta mbajnë fjalën. Për shembull Xi erdhi në Itali në vitin 2019, dhe u duk sikur do të bënte investimesh të madhe, por u tërhoq sapo shpërtheu pandemia".

Gjatë pandemisë Liao ka shkruar një roman dokumentar me titullin "Wuhan", në të cilin ai akuzon Pekinin se ka shkaktuar me vetëdije miliona të vdekur. "Pse

tregtia dhe fluturimet ndërkombëtare për dhe nga Kina u lanë të hapura kur Wuhan hyri në bllokim, duke lejuar kështu që virusi të udhëtonte nëpër botë duke shkaktuar shumë vdekje?"- pyet me të drejtë shkrimtari disident.

Dhe ai akuzon: "Për Pekinin, koronavirusi ishte një mundësi e artë për të vënë në praktikë formën më imponuese, më të përhapur, dhe teknologjikisht më të avancuar të kontrollit mbi çdo aspekt të jetës së popullatës. Xi e tejkaloi edhe fantazinë e George Orwell në vitin e tij Viti1984".

Rezultati është një vend në të cilin qytetarët nuk mund të mendojnë më: "Kinezët nuk janë më njerëz por makineri. Ata kanë më pak të drejta se një qen. Sepse qeni mund të lehtë, ndërsa njerëzit nëse bërtasin, përfundojnë në qeli".

Kur në vitin 2022 shpërtheu protesta e "letrave të bardha" kundër bllokimeve të pafundme të Covid-19, kur njerëzit në rrugë bërtisnin "Poshtë Partia Komuniste! Xi Jinping jep dorëheqjen!" qeveria nuk i dërgoi tanket, por vendosi të heqë papritur të gjitha kufizimet për të frenuar pandeminë.

"Pa vaksina dhe ilaçe, njerëzit që sapo kishin shpëtuar nga bllokimet dhe virusi i Wuhan u lanë të lirë të ndryshonin, u gjendën në mëshira e "Hopit të Madh Përpara" të infeksionit Covid. Numri i njerëzve që u prekën nga koronavirusi u rrit në qindra mijëra, miliona, dhjetëra miliona, qindra miliona dhe brenda një muaji e gjysmë e

tejkalo numrin e të personave të infektuar në mbarë botën në 3 vite rresht. Të vdekurit janë kaq të shumtë në numër, saqë askush nuk di ku t'i varrosë"- thotë disidenti.

Në një moment Liao ngrihet dhe më tregon njerëzit që ecin buzë detit: "Unë e di që Perëndimi po përpiqet të reduktojë varësinë e tij nga Pekini. Unë shoh po asnjë kinez, por turizmi po lulëzon, dhe ju mund ta bëni këtë".

E pyes nëse ëndërron të kthehet një ditë në vendlindje. "Unë e konsideroj Berlinin shtëpinë time të dytë, edhe pse nuk di të flas gjermanisht. Do të kthehesha në Kinë vetëm nëse Sichuani do të bëhej i pavarur"- përgjigjet ai.

Më pas mendimet e tij kthehen tek lufta në Ukrainë: "Unë i admiroj shumë ukrainasit për mënyrën se si po luftojnë! Ata absolutisht nuk duhet të lejohen që të mposhten. Një regjim i mbrapshtë mund të duket i fuqishëm, por nëse shihni historinë, ai nuk ka asnjë vlerë. Sepse krimet e tij janë regjistruar që të gjitha. Dhe ndonëse mund ndihemi të parëndësishëm tani për t'i mbledhur ato, dëshmia që lëmë pas në terma historikë, do të zgjasë më shumë sesa çdo tirani".

Gjatë ceremonisë së ndarjes së çmimeve, shkrimtari disident merr në dorë xixo-n, flautin kinez që mësoi ta luante në burg, falë një murgu të moshuar. "Muzika të jep një liri të brendshme, dhe diktaturat kanë frikë nga ajo"- më thotë ai, teksa notat e luajtura me këtë instrument u përhapën në të gjithë sallën.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Drita 'peshkon' Viktoria Plzenin në Ligën e Konferencës

Drita në raundin e dytë të Ligës së Konferencës do të përballet me Viktoria Plzenin. Trajneri i Akis Vavalis e ka konsideruar skuadrën çeke shumë të fortë, por nuk dorëzohet dhe është i gatshëm që me skuadrën gjilanasë të luftojë për kualifikim. "Të gjithë e dinë që nuk jemi favoritë për këtë ndeshje, por do të luftojmë për shanset tona", ka thënë Vavalis. Kundërshtarë të mundshëm në rrethin e dytë e kanë edhe Ballkani, Gjilani dhe Dukagjini

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 21 qershor - Klubi nënkampion i Kosovës, Drita e Gjilanit, do të marrë pjesë në garat e Ligës së Konferencës. Kundërshtar i skuadrës së Dritës në raundin e dytë është ekipi nga Çekia, Viktoria Plzen. "Jemi krijuar për ndeshje të mëdha. Si gjithmonë shorti na ka vendosur përballë një kundërshtari të fortë siç është FC Viktoria Plzen nga Çekia", thuhet në reagimin e Dritës pas shortit.

Skuadra çeke është mjaft cilësore dhe një gjë të tillë e ka pranuar edhe trajneri i Akis Vavalis, i cili ka thënë se kundërshtari është i fortë, që dëshmohet me pjesëmarrjen në fazën e grupeve në vitet e fundit, por ai ka premtuar se gjilanasit do të angazhohen dhe të luftojnë për shanset e veta. "Një ndeshje shumë e rëndësishme. Kemi një kundërshtar shumë të vështirë, i cili vitet e fundit ka luajtur në faza të grupeve. Klubi ynë në vitet e fundit ka dëshmuar që kundër kundërshtarëve të fortë



ka pasur paraqitje të shkëlqyera dhe shpresojmë shumë që edhe këtë vit të bëjmë befasi. Të gjithë e dinë që nuk jemi favoritë për këtë ndeshje, por do të luftojmë për shanset tona. Do të jetë një ndeshje e madhe dhe një mundësi e mirë për të gjithë lojtarët tanë dhe për

tifozët tanë që të shohin një ndeshje rivale", ka thënë Akis Vavalis. Ndeshja e parë do të zhvillohet më 27 korrik, ndërsa ajo e kthimit më 3 gusht. Ndërsa të mërkurën skuadra kampione e Superligës së Kosovës, Ballkani, e ka mësuar kundërshtarin e

dytë eventual në Ligën e Kampioneve. Në rast se portokallezinjtë arrijnë ta kalojnë sfidën kundër kampionit të Bullgarisë, Ludogorets, atëherë në rrethin e dytë do të takohen me fituesin e ndeshjes ndërmjet Olimpia Lubjanës së Sllovenisë dhe Valmieras së Letonisë. E nëse humb nga Ludogorets, atëherë Ballkani do t'i vazhdojë garat në Ligën e Konferencës, ku do të ballafaqohet me humbësin e ndeshjes Helsinki - Larnë. Kundërshtarët e rrethit të dytë i kanë mësuar edhe Gjilani dhe Dukagjini në Ligën e Konferencës. Gjilani nëse e kalon me sukses sfidën e rrethit të parë me skuadrën nga Luksemburgu, Progress Niederkorn, do të takohet me skuadrën daneze Midtjylland, ndërsa Dukagjini në rast se e kalon skuadrën Europa nga Gjibraltari, në rrethin e dytë do të ketë punë me skuadrën e njohur kroate, Rijeka.

Klubet e Superligës nuk rrinë duarkryq

Klubet e Superligës, të cilat llogariten pretendente për garën për titullin e kampionit në Kosovë, kanë filluar të bëjnë ndryshime. Drita është përforcuar me një sulmues afrikan, kurse Ballkani e ka marrë Gentrin Halilin nga Ferizaj. Prishtina ka ndarë rrugët me mbrojtësin Egzon Belica

EPOKA ERE Veton ZYMBERI

Prishtinë, 21 qershor - Klubet elitare në futbollin e Kosovës po vazhdojnë të bëjnë ndryshime e të përforcohen për edicionin e ri 2023/2024. Skuadra e Dritës ka goditur fuqishëm duke u përforcuar me një futbollist mjaft cilësor. Fjala është për sulmuesin Erson Stiven Dias Costa, i cili ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me nënkampionët e Kosovës, ndërsa në edicionin e kaluar ishte pjesë e skuadrës portugeze Covilha. "Erson Stiven Dias Costa është sulmuesi ynë. Kemi kënaqësinë t'jua prezantojmë

sulmuesin tonë të ri Dias Costa nga Cabo Verde e Afrikës. Costa do të jetë pika referente e sulmit, i cili vjen nga një përvojë e gjatë në ligën e parë të Portugalisë dhe Superligën e Bullgarisë. Tani e tutje aventurën do ta vazhdojë në klubin tonë. Marrëveshja është arritur për periudhën njëvjeçare dhe përvoja e Dias do të jetë shumë e nevojshme për sulmin tonë", thuhet në njoftimin e Dritës. Edhe kampioni në fuqi, Ballkani, njoftoi për arritjen e marrëveshjes me Gentrin Halili. Mbrojtësi i ri u largua nga Ferizaj dhe vendosi që karrierën të vazhdojë në klubin kampion. "Kemi kënaqësinë t'jua



prezantojmë përforcimin e ri të skuadrës, mbrojtësin Gentrin Halili. Klubi i dëshiron suksese Gentrin drejt realizimit të objektivave të përbashkëta", thuhet në njoftimin e klubit nga Suhareka. E Prishtina i ka ndarë rrugët me

një lojtar. Mbrojtësi me përvojë të madhe Egzon Belica është larguar nga klubi kryeqytetas. "FC Prishtina dhe mbrojtësi Egzon Belica e kanë ndërprerë bashkëpunimin pasi që lojtarit i ka përfunduar kontrata. 32-vjeçari i ardhur te skuadra jonë

në shtator të vitit të kaluar largohet nga Prishtina me një trofe, Kupën e Kosovës. Prishtina e falënderon Belicën për kontributin e dhënë për ekipin dhe i dëshiron suksese në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Nedim Yigit emërohet trajner i Lirisë

Klubi i rikthyer në Superligë, Liria, ka konfirmuar zyrtarisht emërimin e trajnerit të ri, turkut Nedim Yigit. Prizrenasit u inkuadruan në elitë nën drejtimin e trajnerit shqiptar nga Maqedonia e Veriut, Xhengis Rexhepi, me të cilin ndërpreu bashkëpunimin ditë më parë. Trajneri Yigit është shprehur i kënaqur që mori drejtimin e skuadrës së Lirisë. "Do të bëjmë punë të mira. Do ta jap gjithë dijen time që ekipin ta dërgojmë në nivele të larta", ka deklaruar Yigit.


Galatasaray e dëshiron Muriqin në vend të Icardit

Stamboll, 21 qershor - Vedat Muriqi pati një sezon mbresëlënës në Spanjë me Mallorcan duke e mbyllur edicionin 2022/23 me 15 gola në La Liga dhe një tjetër në Kupën e Spanjës, derisa kontribuoi edhe me katër

asistime. "Pirati" mund të mos qëndrojë tek ishullorët edhe pse ka kontratë deri në vitin 2027. Mediumi turk "Aksam" raporton se futbollistit nga Kosova ia ka vënë syrin gjigantit nga Stambolli, Galatasaray. Muriqi kishte

luajtur në këtë qytet, por me një gjigant tjetër, Fenerbahçe, ku e kishte arritur kulmin e karrierës në atë kohë. Megjithatë, tash në garë për 29-vjeçarin është futur klubi verdh e kuq, ku me sukses në sezonin e fundit luajti ylli tjetër kosovar,

Milot Rashica, i cili mund të mbetet në këtë klub nëse arrihet marrëveshja me Norwich Cityn. Galata Muriqin e sheh si zëvendësues ideal të Mauro Icardit, i cili pritet të largohet gjatë verës pasi ka oferta të shumta.



Gjilani e mendon rikthimin e Mezanit

Gjilan, 21 qershor - Largimi i Zekirja Ramadanit nga Gjilani ka lënë një boshllëk në karrigen e shtabit teknik të skuadrës, megjithatë drejtuesit tashmë kanë

nisur të mendojnë për një zgjedhje të shpejt. Tash për tash skuadra i është besuar ndihmësit Alban Hyseni, megjithatë, bëhet e ditur se klubi është në bisedime

me ish-trajnerin Gentian Mezan. Vlonjati e njeh shumë mirë ambientin gjilanas pasi edhe më herët ka punuar aty dhe rikthimi i tij do të ishte shumë më i lehtë. Të

kujtojmë se Gjilani është kualifikuar në garat e Ligës së Konferencës ku do të ballafaqohet me FC Progres Niederkorn.



Sylvinho: Jemi plotësisht në garë për t'u kualifikuar

Tiranë, 21 qershor - Kombëtarja e Shqipërisë ka regjistruar fitoren e dytë radhazi në kuadër të kualifikimeve për Kampionatin Evropian "Euro 2024". Pasi mposhtën Moldavinë tri ditë më parë, të përzgjedhurit e Sylvinhos triumfuan mbrëmë ndaj Ishujve Faroe. Ndeshja e zhvilluar në stadiumin "Torsvollur" përfundoi me rezultatin 1-3. Pas ndeshjes, Sylvinho e pranoi se ishte e vështirë fitorja. "Është e vështirë të luash këtu. Topi i gjatë të vendosë në vështirësi. Ata kanë lojtarë të gjatë. Me një top të gjatë të hapen probleme dhe krijohen situata të paparashikueshme. Djemtë bënë shumë mirë, treguan shpirt të lartë gare, treguan unitet. Të gjithë lojtarët kanë bërë punë shumë të mirë këto ditë", ka thënë Sylvinho për "Supersport".



Përzgjedhësi i Kombëtares shqiptare foli edhe për shanset për t'u kualifikuar në "Euro 2024". Shqipëria është e dyta në Grupin E. "Njësoj janë shanset. E rëndësishme ishte të fitonim dy ndeshjet tona. Ka ndodhur përpara dy vjetësh, gjatë

pandemisë, që Shqipëria fitonte dy ndeshje radhazi. E kam thënë që në fillim se grupi është i vështirë dhe i ekuilibruar, por asgjë nuk ndryshon. Jemi të kënaqur për dy fitoret dhe jemi plotësisht në garë për kualifikimin", ka shtuar Sylvinho.

Ronaldo: Karriera ime ende nuk ka përfunduar

LISBONË, 21 QERSHOR - Portugalia arriti fitoren e katërt radhazi në fazën kualifikuese të Kampionatit Evropian të Futbollit "Euro 2024", teksa mundi në Rejkjavik, Islandën me rezultatin 0 me 1, pas golit të vetëm të sfidës të shënuar nga "heroi" i "luzitanëve", Cristiano Ronaldo. Ronaldo shënoi golin e fitores në ndeshjen e tij të 200 për kombëtaren, "rekord" ky që, përveçse hyri në librin e famshëm "Guinness", e motivon edhe më shumë pesë herë fituesin e "Topit të Artë" për të vazhduar të dhurojë



spektakël në fushën e futbollit dhe një gjë të tillë e tha vetë Ronaldo pas përfundimit të ndeshjes. "Jam shumë i kënaqur të di që vazhdoj të kënaq shumë njerëz jo vetëm në Portugal, por edhe përtej kufijve të saj me karrierën time, e cila

ende nuk ka përfunduar. Mbi të gjitha, dua të vazhdoj kështu, sepse jam ende i dobishëm, jam ende duke ndihmuar, ende po shënoj gola. Është më e rëndësishmja. Për sa kohë që ndihem mirë, ndihem i dobishëm dhe shoh që njerëzit vazhdojnë të më duan dhe duan ta shohin kontributin tim, unë do të jem gjithmonë i vërtetë ndaj ekipit portugez, vendit tonë dhe ngjyrave tona. Jam shumë krenar që jam portugez", ka thënë Ronaldo.

Red Bull: Ferrari ishte më i shpejtë në Kanada, për fat u nisën pas nesh

Skuadra e Ferrarit u klasifikua në vendet 4-5 në garën e fundit në Kanada dhe, sipas drejtuesve të Red Bullit, kjo nuk ishte një rastësi. Helmut Marko, një nga drejtuesit e makinës kampione në Formula 1, e kishte parashikuar të premtën këtë paraqitje të mirë të "kokëkuqes", kur pa rezultatet e provave të lira. "Për fatin tonë, Ferrari u nis nga vendet 10-11 në garë. Në rast se do të ishin nisur në vendet e para do ta fitonin garën. Makina italiane ishte më e

shpejtë se ne me të dyja gomat e përdorura në garë, ato të mesme dhe ato të forta, ndaj nëse do të kishim dueluar me to, do të kishim humbur", ka thënë Marko. "Ne patëm mjaft probleme me gomat në Kanada për t'i sjellë në temperaturën e duhur. Madje me Verstappenin patëm edhe një problem me një zog që goditi e ngeci në makinën e tij. Nuk e mendonim fitoren në Kanada pas të premtës, pasi pamë që Ferrari ishte i shpejtë,



por ata patën probleme me kualifikimin të shtunën dhe kjo na favorizoi në garë", ka deklaruar Marko.

Katër çiftet shumë perspektive të gjyqtareve të hendbollit

Prishtinë, 21 qershor - Ndeshjet e "Final 8" të Ligës së Pioniereve në hendboll janë drejtuar nga gjyqtare me perspektivë. Të gjitha ndeshjet u janë besuar gjyqtareve të reja, që ishin të angazhuara edhe gjatë pjesës

së rregull të kampionatit. Çiftet Anesa Maksuti-Elda Hoxha, Flaka Hoti-Edonisa Sahiti, Donita Shala-Diarta Shala dhe Dorentina Qufaj-Ardiana Imeraj kanë shfaqur seriozitet, maturi dhe potencial për t'u

zhvilluar në gjyqtare të rëndësishme të hendbollit. Ato janë vlerësuar për punën që e kanë bërë dhe për mënyrën se si i kanë menaxhuar ndeshjet vendimtare për titull të kampionit të pionieret. FHK-ja

është e përkushtuar për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre gjyqtareve, por edhe e të gjithë gjyqtarëve dhe zyrtarëve të tjerë të ndeshjeve. Turneu final i Ligës së Pioniereve është zhvilluar në Gjakovë.



SHKURT

Betim Fazliji kthehet në St. Gallen

Mbrojtësi Betim Fazliji është rikthyer në FC St. Gallen 1879. Lajmin e ka konfirmuar klubi zviceran, derisa reprezentuesi "dardan" ka nënshkruar kontratë me klubin nga Superliga zvicerane deri në vitin 2027. Fazliji kaloi një vit te FC St. Pauli, ku zhvilloi 19 ndeshje në Bundesliga 2 me klubin nga Hamburgu, por klubet arritën marrëveshje që lojtari të rikthehej në shtetin "Helvetik". "I lumtur që rikthehem në familjen gjelbër e bardhë. Mezi pres të luaj përpara tifozëve tanë përsëri", ka thënë Fazliji. Ndërkohë, drejtuesit e klubit e presin krahëhapur qendërmbrojtësin, i cili mund të luajë edhe si mesfushor defanziv: "Jemi mjaft të lumtur që Betimi u kthye në shtëpi dhe që nënshkroi kontratë afatgjatë. Ai e njeh mjaft mirë klubin dhe do të ambientohet shpejt".

Milani nuk heq dorë nga transferimi i Brojës

Armando Broja është rikthyer nga lëndimi i rëndë në gju, por tashmë është rikthyer në fushë, i gatshëm për ta bindur trajnerin Pochettino. Dëshira e Brojës ka qenë dhe mbetet e njëjtë, të bëjë vend te Chelsea, klub ku është rritur, me të cilin ka një kontratë deri në qershor 2028. Pavarësisht prej këtij fakti, emri i Brojës mbetet fik në tregun e transferimeve. Sulmuesi kërkohet jo vetëm në Premierë Ligë, por dhe në Serinë A. "Tuttosport" shkruan se Broja është një objektivi i Milanit në këtë merkato vere. Në fakt, Broja është një emër që lidhet në mënyrë konstante me një kalim në "San Siro", "djalli" u përpoq ta joshte edhe gjatë verës së shkuar pasi kishte mbyllur një sezon fantastik me Southamptonin.

Wilderi dhe Ruzi përballen në gusht

Dy ish-boksierë kampionë bote në peshën e rëndë, amerikan Deontay Wilder (43 fitore, 2 humbje e 1 barazim) dhe mexikani Andy Ruiz Jr (35 fitore e 2 humbje) janë pranë marrëveshjes për të dueluar mes tyre në gusht të këtij viti. Lajmin e konfirmoi Malik Scott, trajneri i Wilderit, që ka zbuluar edhe disa detaje nga bisedimet. Sipas Scott, ka disa javë që palët janë duke diskutuar dhe plani është që përballja të zhvillohet në Amerikë në gusht, për t'i dhënë më pas Wilderit të rikthehet në ring në dhjetor, në një duel me Anthony Joshuan. Të dy boksierët kanë qenë kampionë bote në peshën e rëndë, ndër më të mirët e dekadës së fundit. "Për momentin jemi vetëm në fazën e bisedimeve dhe duket se do të bëjmë shumë zhurmë duke e arritur marrëveshjen. Andy Ruzi është një opsion shumë i mirë për Deontay. Do të dëshiroja që këtë sfidë ta shihja në Las Vegas, pasi aty të dy boksierët kanë shumë fansa", ka thënë Malik Scott.

Flick: Jam i zhgënjyer nga gjithçka, kemi prekur fundin

Gjermania humbi në ndeshjen miqësore nga Kolumbia me rezultat 0-2. Trajneri Hansi Flick është shprehur i zhgënjyer dhe ka thënë se gjermanët e kanë prekur fundin. "Tepër i zhgënjyer. Kontingjenti nuk ishte në gjendje të vinin në zbatim lëvizjet që kemi aplikuar në seancat stërvitore. Ne dëshironim të provonim diçka ndryshe në këto teste, por ja që përfundimi nuk dha produktivitet. Justifikimet janë të kota në këtë pikë. Kërkohet një analizë e thellë për të kuptuar se çfarë po ndodh. U kërkoj falje tifozëve. Ata besonin te ne. Shpresoj se skena të tilla do të harrohen. Komponenti, i cili më shqetëson më tepër, koïncidon me mungesën e besimit të grupi. Eliminimi i këtij faktori mbetet jetik", ka thënë Flick.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati/ Sekretarijat/ Secretariat



Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr. 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, në bazë të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Kosovës, në bazë të Aktgjykimit nr. Ref AGJ.1583/20 të datës 09 Korrik 2020 si dhe Vendimit të Këshillit Prokurorial të Kosovës KPK/Nr. 193/2023 të datës 23 Shkurt 2023, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpall këtë:

KONKURS

I. Mbrojtës i Viktimave

Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave Prishtinë, një (1) pozitë

Referenca:	KPK/ZKPSH/ZMNV/POZ-011
Emri Pozitës:	Mbrojtës i Viktimave
Pozita:	Pozitë e karrierës
Niveli:	Profesional 1
Raporton tek:	Mbikëqyrësi i Zyrës Regjionale
Numri i Pozitave:	Një (1) pozitë
Klasa:	P 14
Koeficienti:	5.85
Akti i emërimit:	Pa Afat
Puna provuese:	Dymbëdhjetë (12) muaj
Vendi:	Prishtinë

Qëllimi i vendit të punës:

Brenda fushës specifike të ekspertizës, kryen detyra profesionale dhe ofron shërbime si zyrtar i autorizuar për të ndihmuar, udhëzuar viktimat e krimit nga dhuna, keqtrajtimi fizik e psikik, të trafikimit dhe të abuzimeve, të gjitha shërbimet pa pagesë, që të kenë qasje me te lehte nga çasti i viktimizimit, duke bashkëpunuar me institucionet e tjera gjerë në përfundim të procedurës gjyqësore.

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Zhvillon dhe arrin pëlqimin për planet e punës dhe afatet me menaxherin dhe stafin tjetër profesional për zbatimin e shërbimeve dhe produkteve përkatëse në fushën e mbrojtjes së Viktimave;

Përfaqëson viktimat e krimit në organet për zbatimin e ligjit;

Organizon punën e vet në ofrimin e shërbimeve pa pagesë për viktimat e pësuar nga çdo lloj i krimit, duke udhëzuar dhe mbështetur në mbrojtjen e të drejtave të tyre para ligjit;

Ofron shërbimet profesionale me hartim të akteve, kërkesave dhe shkresa, të nevojshme për të cilat ka nevojë viktimat në përballje me sistemin e drejtësisë, të gjitha në pajtim me ligjet e aplikueshme që zbatohen nga ZMNV-ja, duke u kujdesur gjithnjë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mos ndërhyrje nga jashtë;

Bashkëpunon ngushtë me institucionet tjera si Agjencitë e përforcimit të ligjit, Qendrat për punë sociale, institucionet mjekësore, organizatat qeveritare dhe joqeveritare, për të siguruar ofrimin e shërbimeve tjera për viktimat e krimit; Zbaton politikat, strategjinë dhe vendimet e Zyrës për MNV, e të Kryeprokurorit të Shtetit, duke e raportuar punën e kryer në afate të parapara kohore në nivel të institucionit në mënyrë të drejtpërdrejtë Menaxherit të Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave;

Mbanë kontakte të përhershme me drejtorin e ZMNV, si dhe në relacion me viktimat dhe rastet e paraqitura duke iu përgjigjur rasteve në çdo kohë brenda 24 orëve, komunikon me telefon dhe kujdestaron në pritje sipas njoftimeve e rasteve edhe nga ZMNV;

Përgjegjës për respektimin e orarit të punës, përdorim të ndershëm të mjeteve të punës duke mos i keqpërdorur apo dëmtuar me qëllim, për vijueshmëri, disiplinë në punë, respektim të Kodit të etikës dhe mirësjelljes së stafit mbështetës do kujdeset eprori i stafit mbështetës i institucionit ku është e vendosur zyra;

Kryen edhe punë të tjera të cilat i caktohen nga udhëheqësi i drejtpërdrejtë apo eprori më i lartë e që janë në relacion me detyrat e punës dhe shërbimet brenda institucionit.

Njohuritë, shkathtësitë dhe aftësitë për vendin e punës:

Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar dhe trajnimeve përkatëse;

Njohuri të ligjeve dhe rregullores të aplikueshme;

Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;

Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;

Shkathtësi reagimi të duhur në zgjidhjen e problemeve me ndërmarrje të iniciativave konkrete në punë;

Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel) me njohuri për qasje elektronike.

Përgatitja profesionale dhe kualifikimi:

Diplomë Universitare- Fakulteti Juridik.

Përvoja e punës

Minimum 2 vite përvojë pune profesionale.

- Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga dita e publikimit në faqen zyrtare të Sistemit Prokurorial të Republikës së Kosovës, si dhe në gazetën ditore, duke filluar nga data 22.06.2023 deri me datë 06.07.2023 si datë e mbylljes së konkursit.
- Kërkesa (aplikacioni) për punësim gjendet në web faqen: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00, në Divizionin e Burimeve Njerëzore, kati IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, rruga "Luan Haradinaj", 10000 Prishtinë, Kosovë.
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj", kati i IV, objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
- Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim, nëse arrijnë brenda 4 katër ditësh, aplikacionet që arrijnë pas këtij afati, dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen fare.
- Në rast nevojë mund të na kontaktoni në, tel: 038/200 66048, 038/200 66029, prej orës 08:00 – 16:00.
- Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:
 - Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.
 - Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.
 - "Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës."
- Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten kopjet e skanuara të dokumentacionit të kërkuar:
 - Dëshminë e kualifikimit shkollor;
 - Dëshmi mbi përvojën e punës;
 - Dëshmi e trajnimeve;
 - Dy rekomandime (nëse keni);
 - Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës (nëse ekzistojnë të tilla);
 - Dokumentin e identifikimit-letërnjoftimi i fotokopjuar;
 - Certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime.
- Në lidhje me datën e mbajtjes së testit me shkrim dhe intervistës, për kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet e parapara sipas këtij konkursi, kandidatët do të njoftohen bazuar në legjislacionin në fuqi.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Make Up Group" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810244096 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Make Up Group" D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810244096 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability "Make Up Group" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810244096 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council
Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat



Na osnovu člana 31 Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom Savetu Kosova, na osnovu Zakona br.03/L-149 o Civilnoj službi Republike Kosova i Pravilnika br. 02/2010 o Postupku Zapošljavanja u Civilnoj Službi Kosova, u skladu sa Presudom br. Ref AGJ.1583/20 od 09. jula 2020. godine kao i Odluke Tužilačkog Saveta Kosova KPK/br. 193/2023 od 23 februar 2023 godine, Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova ponovno objavljivanje:

KONKURS

I. Službenik za Zaštitu Žrtava

Kancelarija za Zaštitu i Pomoć Žrtvama Priština, jedna (1) pozicija

Referenca: KPK/ZKPSH/ZMNV/POZ-011
Ime pozicije: Službenik za Zaštitu Žrtava
Pozicija: Pozicija od karijere
Nivo: Profesionalno 1
Raportira kod: Rokovodilac Regionalne Kancelarija
Broj pozicija: Jedna (1) pozicija
Klasa: P 14
Koeficijent: 5.85
Akt Imenovanja: Na neodređeno
Probni rad: Dvanaest (12) meseci
Mesto: Priština

Cilj radnog mesta:

U okviru specifične oblasti ekspertize, obavlja stručne obaveze i pruža usluge kao ovlašćeni službenik da pomaže, upućuje žrtve nasilnog kriminala, fizičkog i psihičkog zlostavljanja, trafikovanja i zloupotrebe, sve besplatne usluge, kako bi imali lakši pristup od trenutka viktimizacije, saradujući sa ostalim institucijama do kraja sudskog postupka.

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Odvija i postiže dogovor o planovima rada i rokovima sa menadžerom i ostalim stručnim osobljem sprovedenju usluga i odgovarajućih proizvoda iz oblasti pomoć žrtvama;

Predstavlja žrtve zlocina u organima za sprovođenje zakona;

Organizuje svoj rad u pružanju besplatnih usluga nastradalim žrtvama od svih vrsta kriminala, upućujući ih i podržavajući ih u zaštiti njihovih prava pred zakonom;

Pružna stručne usluge u izradi potrebnih akata, zahteva i prepiska, koje su potrebne žrtvama usuočavanju sa sistemom pravosuđa, sve u skladu sa zakonima koji su na snazi a koji se sprovode odstrane KZPŽ-a, pobrineći se uvek o sačuvanju konfidencijalnosti i neupličenju sa spoljnih strana;

Usko saraduje sa ostalim institucijama kao i Agencijama o ojačanju Zakona, Centrima za Socijalni Rad, zdravstvenih institucija, vladinih i nevladinih organizacija, da bi se obezbedilo pružanje ostalih usluga za žrtve kriminala;

Sprovodi politike, strategiju i odluke Kancelarije ZPŽ, i Glavnog Državnog Tužioca, izveštavajući na direktan način Direktor Kancelarije za Zaštitu i Pomoć Žrtvama;

Održava stalne kontakte sa direktorom KZPŽ kao i u relaciji sa žrtvama i predstavljanim

slučajevima odgovoreći na slućajeve u svako vreme u roku od 24 časova, komunicira telefonom i dežura na čekanju prema obaveštavanju i slućaju i od KZPŽ;

Odgovorno za poštovanje radnog vremena, iskrenu upotrebu radnih alata bez zloupotrebe ili namernog oštećenja, za kontinuitet, radnu disciplinu, poštovanje Etičkog kodeksa i ljubaznost pomoćnog osoblja pobrinut će se pomoćno osoblje nadređeno instituciji u kojoj je kancelarija. se nalazi;

Obavlja i ostale poslove koje mu se odrede od strane direktnog rukovodioca ili višeg adzornika akoje su u relaciji sa radnim obavezama i uslugama unutar institucije.

Znanja, veštine i sposobnosti za radno mesto:

Duboko znanje iz specifične stručne oblasti stećeno putem univerzitetskog obrazovanja i odgovarajućih obuka; Poznavanje važećih zakona i propisa; Komunikativne veštine, radno planiranje, eventualno koordiniranje osoblja u administrativnom nivou; Istraživne, analitičke, vrednosne sposobnosti i formuliranje preporuka i stručnih saveta; Ispravne veštine u rešavanju problema uz preduzimanje konkretnih inicijativa u radu; Kompjuterske sposobnosti u aplikacijama programa (Word, Excel)uz znanje za elektronski pristup.

Stručna Sprema i kvalifikacija:

Univerzitetska Diploma- Pravni Fakultet.

Radno Iskustvo:

Minimum 2 godine profesionalnog radnog iskustva.

- Konkurs je otvoren 15 kalendarskih dana od dana objavljivanja na službenoj stranici Tužilačkog Sistema Kosova, kao i u dnevne novine, počevši od 22.06.2023 do 06.07.2023 kao datum isteka konkursa.

- Prijava (aplikacije) za zaposlenje dostupna je na Internetu: www.prokuroria-rks.org
- Aplikacije se predaju svakog radnog dana od 08:00 do 16:00, u Diviziji Ljudskih Resursa, IV sprat, Objekat Specijalno Tužilaštvo Republike Kosovo, ul. „Luan Haradinaj“, 10000 Priština, Kosovo.
- Prijava poštom: Zahtevi popunjeni dokumentima takođe se mogu predati poštom Odeljenju za Ljudske Resurse Sekretarijata Tužilačkog Saveta Kosova, adresa: Rr. „Luan Haradinaj“, IV sprat, Objekat Specijalno Tužilaštvo Republike Kosovo, 10000 Priština.
- **Aplikacije poslate putem pošte**, koje sadrže poštanski pečat nad pošiljkom sa datumom poslednjeg dana roka za apliciranje, smatraće se važećim i uzeće se na razmatranje, ako stižu u roku od 4 dana, aplikacije koje stižu posle ovog roka ili su nekompletirane neće se uzeti u obzir uopšte.
- U slućaju potrebe možete da nas kontaktirate na, tel: 038/200 66048, 038/200 66029 od 08:00 do 16:00 časova.
- **Uslovi učešća na konkursu:**Pravo apliciranja imaju svi građani Republike Kosova odrasle dobi koji imaju punu sposobnost delovanja, poseduju civilna i politička prava, imaju potrebnu školsku spremu i stručne sposobnosti za vršenje dužnosti kao i fizičkih sposobnosti koja se traže za dotičnu poziciju. Sekretarijat Tužilačkog Saveta Kosova, pruža jednake mogućnosti zapošljavanja svim državljanima Kosova i doćekuje aplikacije od sviju osoba muškog i ženskog pola iz redova svih zajednica na Kosovu. „Nevećinske zajednice i njihovi pripadnici imaju pravo na pravedno i proporcionalno zastupanje u organima civilne službe centralne i lokalne države administracije kao što je specifikovano članom 11, stav 3 Zakona br. 03/L-149 za Civilnu Službu Republike Kosova“.
- **Aplikacijama se moraju sastaviti kopije zatražene dokumentacije:**
 - Svedoćanstvo školske spreme;
 - Dokaz o radnom iskustvu; Potvrda i radni ugovor;
 - Dokaz o obuci;
 - Dve preporuke (ako imate);
 - Kopije dva poslednja naizmenična izveštaja procene rada (ako takvi postoje);
 - Dokument identifikacije-fotokopirana lićna karta;
 - Uverenje od Suda da niste pod istragom.
- U vezi datuma održavanja pismenog testa i intervjuja, za kandidate koji ispunjavaju uslove koji su predviđeni na osnovu ovog konkursa, kandidati biće obavešteni na osnovu važećeg zakonodavstva.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Luljeta Mullazenuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m.Normalë "Hysni Zajmi"

- Artiola Batusha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elvira Perteshoni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Mjekësisë "Hysni Zajmi".

- Florjan Hajdaraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl, 10 të SH.M. Ekonomike "Kadri Kusari".

- "Asosacioni Alter" shpall të pavlefshme certifikatën e numrit fiskal me nr. 602772445.

- Nahit Shala nga Rogova e Gjakovës shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike " Nexhmedin Nixha".

- "Haja" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810191643.

- Virxhina Barbullushi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" në Gjakovë.

- Saranda Marashi nga Ramoci KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. "Luigj Gurakuqi" Korenic KK Gjakovë nga kl. I-V dhe VI-IX.

- Muhamet Zherka shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Lulzim Avdiu, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Arkitekt Sinani"

- Leon Kuqanaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFCI".

- Vehbi Ahmeti, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "Xheladin Deda"

- Albana Peci shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 te shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- Fitore Xhemajli, shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "Fazli Grajqevci"

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Hysen Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi –Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

"HORTIKULTURA" SH.A.
Nr. 1375
Dt. 22.06.2023
PRISHTINË



Bazuar në vendimin e Bordit të Drejtorëve nr.1362 të datës 21.06.2023 si dhe dispozitave të nenit 21 të Ligjit nr. 03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike, respektivisht dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, nenit 5 pika 5.3 të Statutit të NPL "Hortikultura" SH.A, Bordi i Drejtorëve të NPL "Hortikultura" SH.A me datë 22.06.2023 shpallë konkurs publik për këtë pozitë:

Titulli i pozitës: **Këshilltar i Përgjithshëm/Sekretar i Korporatës**

Kohëzgjatja e kontratës: **3 vite me mundësi vazhdimi.**

Orari i punës: **I plotë**

Niveli i pagës: **Sipas Rregullores së Brendshme të Ndërmarrjes**

Vendi: **Prishtinë**

Kualifikimet dhe përgatitja profesionale

- Të posedojë diplomë universitare -Fakulteti Juridik (jurist i diplomuar ose master në shkencë juridike);
- Të posedojë së paku pesë (5) vite përvojë profesionale ose 3 menaxheriale.
- Demonstrim i aftësive të shkëlqyeshme për analizim dhe
- Të plotësojë kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 si dhe të plotësojë kriteret e pavarësisë sipas nenit 17.2 pikat (d),(f),(j),(k),(l) të Ligjit nr. 03/L-087 të Ndërmarrjeve Publike dhe Plotësim Ndryshimit të LNP nr. 04/L-111 neni 13;
- Të posedojë njohuri të punës me kompjuter;
- Njohja e gjuhës angleze (e dëshirueshme);

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Këshilltari i Përgjithshëm/Sekretari i Korporatës ka këto detyra dhe përgjegjësi:

- -kujdeset për aplikimet e plota të akteve normative të ndërmarrjes;
- -mirëmban regjistrin e aksionarëve; - vepron si agjent i ndërmarrjes për pranimin e njohtimeve;
- -kryen të gjitha arkivimet, publikimet dhe zbulimet për autoritetet përkatëse siç mund të kërkohet me ligj ose statut;
- -kordinon me KSHE përgatitjen e letrave (dokumente) për mbledhjet e Bordit të Drejtorëve;
- -përfaqëson ndërmarrjen në organet gjyqësore sipas autorizimit;
- -përpilon kontrata dhe jep mendime profesionale;
- -kryen punë nga lëmia e të drejtës, përpilon kontratë për punësim, dhe vendime dhe aktvendime,
- -azhuron dhe mirëmban dosjet e personelit;
- -përmes këshillave kujdeset për implementimin e ligjeve, statutit, kodit të etikës dhe qeverisjes së ndërmarrjes;
- -komunikon me Njësinë për politika dhe monitorimin të Ndërmarrjeve publike duke dërguar dhe pranuar dokumentacionet sipas ligjeve në fuqi;
- -kryen dhe punë tjera të caktuar me ligj dhe me statut të ndërmarrjes;
- -për punën e tij i përgjigjet bordit të drejtorëve dhe kryeshefit ekzekutiv.

Informatë për procedurën e konkurimit

Aplikantët e interesuar për këtë vend pune duhet të bashkangjesin këto dokumente:

- Aplikacionin e plotësuar;
- CV e aplikantit;
- Diplomën universitare nga Fakulteti Juridik;
- Dëshminë mbi përvojën e punës, referencat si dhe certifikata tjera profesionale;
- Deklaratën nën Betim;
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo me e vjetër se 6 muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Aplikantët e interesuar kërkesën për aplikim me dokumentacion të rregullt, duhet ta paraqesin në arkivin e NPL "Hortikultura" Sh.A., Rr. Tahir Zajmi në Prishtinë objekti i Zjarrëfikësve, çdo ditë pune prej orës 07:00 - 15:00, në afat prej 30 ditësh nga data e publikimit të konkursit në njetet e informimit. Data përfundimtare për dorëzimin e aplikacioneve është **21.07.2023**. Aplikacioni mund të merret në zyrat e ndërmarrjes.

"HORTIKULTURA" SH.A.
Nr. 1375
Dt. 22.06.2023
PRISHTINË



Na osnovu odluke Upravnog odbora br. 1362 od 21.06.2023 kao i odredbe člana 21. Zakona br. 03/L-087 o javnim preduzećima, odnosno odredbe člana 13. Zakona br. 04/L-111 za izmenu i dopunu zakona br. 03/L-087 za Javna preduzeća, član 5 tačka 5.3 Statuta NPL "Hortikultura" SH.A., Upravni odbor NPL "Hortikultura" SH.A. od 22.06.2023. godine raspisuje javni konkurs za ovu poziciju :

Naziv funkcije: **Generalni savetnik/korporativni sekretar**

Trajanje ugovora: **3 godine sa mogućnošću produženja.**

Radno vreme: **Puno radno vreme**

Visina plata: **Prema internom pravilniku preduzeća**

Mesto: **Priština**

Kvalifikacije i stručna obuka

- Da poseduje visoku stručnu spremu - Pravni fakultet (diplomirani pravnik ili magistar pravnih nauka);
- Poseduje najmanje pet (5) godina profesionalnog ili 3 godine menadžerskog iskustva.
- Demonstracija odličnih analitičkih sposobnosti i
- Da ispunjava uslove kvalifikacije prema članu 17.1 kao i da ispunjava kriterijume nezavisnosti prema članu 17.2 tačke (d), (f), (j), (k), (l) Zakona br. 03/L-087 javnih preduzeća i izmene i dopune ZPP br. 04/L-111 član 13;
- Poznavanje rada na računaru;
- Poznavanje engleskog jezika (poželjno);

Glavne dužnosti i odgovornosti:

Generalni savetnik/korporativni sekretar ima sledeće dužnosti i odgovornosti:

- - stara se o potpunosti primeni normativnih akata preduzeća;
- -vodi registar akcionara; - deluje kao agent preduzeća za prihvatanje obaveštenja;
- -podnošenje svih podnesaka, publikacija i obelodanjivanja relevantnim organima u skladu sa zakonom ili statutom;
- - koordinira sa KSHE pripremu pisama (dokumenata) za sastanke Upravnog odbora;
- -zastupa preduzeće u pravosudnim organima po ovlašćenju;
- - sastavlja ugovore i daje stručna mišljenja;
- - obavlja poslove iz oblasti prava, sačinjava ugovore o radu, odluke i rešenja,
- -ažurira i održava dosijee osoblja;
- - kroz savete brine o primeni zakona, statuta, etičkog kodeksa i upravljanja preduzećem;
- - komunicira sa Jedinicom za politike i praćenje javnih preduzeća slanjem i prijemom dokumentacije u skladu sa zakonima na snazi;
- - obavlja i druge poslove određene zakonom i statutom društva;
- - za svoj rad odgovoran je upravnom odboru i glavnom izvršnom direktoru.

Informacije o konkursnoj proceduri

Kandidati zainteresovani za ovu poziciju moraju priložiti sledeću dokumentaciju:

- Popunjena prijava;
- CV podnosioca prijave;
- Univerzitetska diploma Pravnog fakulteta;
- Dokaz o radnom iskustvu, reference i druga stručna uverenja;
- Izjava pod zakletvom;
- uverenje koje nije pod istragom (ne starije od 6 meseci);
- Kopija lične karte;

Zainteresovani aplikanti treba da podnesu zahtev za prijavu sa redovnom dokumentacijom u arhivu NPL "Hortikultura" Sh.A., Rr. Tahir Zajmi u Prištini, Vatrogasni objekat, svakog radnog dana od 07:00 - 15:00 časova, u roku od 30 dana od dana objavljivanja konkursa u medijima. Krajnji rok za podnošenje prijave je 21.07.2023. Prijava se može dobiti u kancelarijama kompanije.

"HORTIKULTURA" SH.A.
Nr. 1367
Dt. 22.06.2023
PRISHTINE



Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës nr.03/L-212, Rregullores mbi organizimin dhe sistematizimin e vendeve dhe detyrave të punës nr.1292 të datë:16.06.2023 si dhe Rregullores për procedurat e rekrutimit, mardhënien kontraktuale dhe avansim në detyrë në ndërmarrje me nr.1338 të datë:20.03.2023, NPL "Hortikultura" shpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të punës

1. Titulli: Drejtor i Administratës

Numri i pozitave: 1

Niveli i pagës: 3

Kohëzgjatja e kontratës: puna provuese 6 muaj, me mundësi vazhdimi.

Kualifikimi:

- diplomë universitare (Juridik, Ekonomik, Shkenca Shoqërore)
- 3 vite përvojë pune
- aftësi të shkëlqyeshme komunikimi
- aftësi e punës në ekip
- njohja e gjuhës angleze e preferuar
- përvojë në institucione publike

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- menaxhon Drejtorinë e Administratës
- menaxhon dhe planifikon aktivitetet në mes të divizioneve që kanë të bëjnë me procedurat dhe kërkesat administrative
- mbikëqyrë dhe vlerëson punën e udhëheqësve të njëjtit nivel të Drejtorisë së Administratës
- bashkëpunon me udhëheqësit e njëjtit nivel në mënyrë që të gjatë vendimet e menaxhmentit të ekzekutohen në interesat e ndërmarrjes:
- përkrah, udhëzon dhe bashkëpunon me udhëheqësit e njëjtit nivel për përbushjen e detyrave
- kujdeset për zbatueshmërinë e rregulloreve, udhëzimeve dhe akteve të tjera juridike të ndërmarrjes
- përpilon raporte periodike për punën e Drejtorisë së Administratës
- harton planin për veprimin e Drejtorisë së Administratës
- kryen punë dhe detyra tjera që lidhen me përshkrimin e detyrave të punës të cilat kërkohen nga KE
- për punën e tij i përgjigjet Kryeshefit Ekzekutiv

2. Titulli: Veterinar/Udhëheqës i Qendrës së Qenëve Endacak

Numri i pozitave: 1

Niveli i pagës: 4

Kohëzgjatja e kontratës: puna provuese 6 muaj, me mundësi vazhdimi.

Kualifikimi:

- diplomë universitare - Fakulteti i Veterinarisë
- 3 vite përvojë pune specifike në fushë veprimtari të qendrës
- aftësi të shkëlqyeshme komunikimi
- aftësi e punës në ekip
- njohja e gjuhës angleze e preferuar

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- organizon të gjitha punët në qendrën për trajtimin e qenëve
- kontrollon dhe vlerëson kafshët e kapura në terren
- në bazë të diagnozës përpilon planin e operimit të kafshëve
- ofron shërbime kirurgjikale për kafshët
- ofron shërbime kujdesi dhe përkujdeset për terapinë post operative të kafshëve
- sigurohet për shëndetin e kafshëve para se atë të lëshohen në qyte
- harmonizon dhe programon bilanci materiale dhe shpenzimet medicinale për njësinë punuese
- mbikëqyr punën e teknikëve të veterinarisë
- kryen edhe punë të tjera me urdhëresë të Drejtorit të Operativës dhe Kryeshefit Ekzekutiv
- për punën e tij i përgjigjet Drejtorit të Operativës dhe Kryeshefit Ekzekutiv

3. Titulli: Teknik Veterinar

Numri i pozitave: 1

Niveli i pagës: 7

Kohëzgjatja e kontratës: puna provuese 6 muaj, me mundësi vazhdimi.

Kualifikimi:

- viti i fundit diplomë universitare - Fakulteti i Veterinarisë
- 1 vit përvojë pune specifike në fushë veprimtari të qendrës
- aftësi të shkëlqyeshme komunikimi
- aftësi e punës në ekip
- njohja e gjuhës angleze e preferuar

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- asiston Veterinarin në organizimin e punëve në qendrën për trajtimin e qenëve
- bën pranimin, regjistrimin dhe pastrimin e kafshës në qendër
- sinkronizon veprimet me planin operativ të hartuar nga Veterinari

- vaksinon dhe vendos qipin në kafshë
- ofron shërbime kujdesi dhe përkujdeset për terapinë post operative të kafshëve
- sigurohet për ushqimin e kafshëve
- harmonizon dhe programon bilanci materiale dhe shpenzimet medicinale për njësinë punuese
- kryen edhe punë të tjera me urdhëresë të eprorit
- për punën e tij i përgjigjet eprorit

4. Titulli: Punëtor fizik për kapjen e qenëve

Numri i pozitave: 1

Kohëzgjatja e kontratës: puna provuese 6 muaj, me mundësi vazhdimi.

Kualifikimi:

- shkolla e mesme
- patentë shofer kategoria B

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- merr direktiva nga Veterinari dhe Drejtorit të Operativës
- kryen shërbime për kapjen e qenëve endacak dhe i transporton në qendër
- sistemon kafshët në kafaze dhe kujdeset për mirëqenien e tyre
- kryen dhe punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarrjes dhe urdhëresës së eprorit,
- obligohet të lëviz nga njësi në njësi- zona të tjera, në raste të veçanta dhe sipas kërkesës së punës me urdhër të drejtorit të operativës
- për punën e tij i përgjigjet Veterinarit, Drejtorit të Operativës dhe Kryeshefit Ekzekutiv

5. Titulli: Mirëmbajtës i Higjienës

Numri i pozitave: 1

Kohëzgjatja e kontratës: puna provuese 6 muaj, me mundësi vazhdimi.

Kualifikimi:

- shkolla e mesme
- 1 vit përvojë pune

Niveli i pagës: 12

Detyrat e punës dhe përgjegjësitë:

- mirëmban pastërtinë e objektit të qendrës;
- mirëmban inventarin e gjithmbarshëm;
- për punën e tij i përgjigjet Udhëheqësit të Qendrës
- pastrimin e zyrave dhe të objektit në përgjithësi,
- pastrimin e tualeteve,
- pastrimin e oborrit dhe hapësirës përreth objekti,
- kryen punë të tjera duke u bazuar në veprimtarinë e ndërmarrjes dhe urdhëresat e eprorit,
- për punën e tij/saj i përgjigjet Udhëheqësit të Qendrës

Procedurat e konkurimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në Arkivën e Ndërmarrjes

NPL "Hortikultura" SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën www.hortikultura-pr.com.

Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në Arkiv në adresën, rr.Tahir Zajmi, pn në Prishtinë, apo përmes Postës së Kosovës.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontraktues si dhe email adresën.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Aplikacionit duhet bashkangjitur:

- Formulari për aplikim i NPL "Hortikultura"
- dëshmit për kualifikim shkollor
- dëshmit për përvojën e punës(Pasqyra e trustit pensional)
- kopjen e letërnjoftimit
- çertifikatën nga Gjykata e cila dëshmon që nuk është i/e dënuar(jo më të vjetër se gjashtë muaj)

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë Brenda dy (2) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Aplikacionet dhe dokumentacioni i pakompletuar sipas kërkesave të përcaktuara në këtë shpallje si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit, nuk do të shqyrtohen.

Shpallja është e hapur që nga data 22.06.2023- 06.07.2023.



Na osnovu članka 8. Zakona o radu br. 03/L-212, Uredbe o organizaciji i sistematizaciji poslovima i zadacima broj 1292 od: 16.06.2023.godine kao i Pravilnik o načinu rada zapošljavanje, ugovorni odnos i napredovanje u službi u poduzeću pod brojem 1338 od datum: 20.03.2023., NPL "Hortikultura" objavljuje:

KONKURS

Za popunjavanje radnih mjesta

1. Zvanje: Direktor uprave

Broj pozicija: 1

Razina plaće: 3

Trajanje ugovora: probni rad 6 mjeseci, uz mogućnost produljenja.

Kvalifikacija:

- VSS (pravni, ekonomski, društveni smjer)

- 3 godine radnog iskustva

- izvrsne komunikacijske vještine

- sposobnost timskog rada

- poželjno znanje engleskog jezika

- iskustvo u javnim ustanovama

Radne dužnosti i odgovornosti:

- rukovodi Upravom za upravu

- upravlja i planira aktivnosti između odjela u vezi s postupcima i administrativni zahtjevi

- nadzire i ocjenjuje rad čelnika podređenih jedinica Uprave za upravu

- surađuje s voditeljima postrojbi kako bi sve upravljačke odluke izvršeno u interesu poduzeća:

- podupire, usmjerava i surađuje s voditeljima postrojbi u ispunjavanju zadaća

- brine se o primjenjivosti propisa, uputa i drugih pravnih akata društvo

- sastavlja periodična izvješća o radu Uprave

- izrađuje plan rada Uprave za upravu

- obavlja poslove i druge poslove u vezi s opisom radnih zadataka koji se zahtijevaju od Europska komisija

- za svoj rad odgovara glavnom direktoru

2. Zvanje: Veterinar/voditelj Centra za pse lualice

Broj pozicija: 1

Razina plaće: 4

Trajanje ugovora: probni rad 6 mjeseci, uz mogućnost produljenja.

Kvalifikacija:

- VSS - Veterinarski fakultet

- 3 godine određenog radnog iskustva u području djelatnosti centra

- izvrsne komunikacijske vještine

- sposobnost timskog rada

- poželjno znanje engleskog jezika

Radne dužnosti i odgovornosti:

- organizira sve poslove u centru za tretman pasa

- provjerava i ocjenjuje životinje ulovljene na terenu

- na temelju dijagnoze izrađuje operativni plan životinje

- pruža kirurške usluge za životinje

- pruža usluge skrbi i skrbi o postoperativnoj terapiji životinja

- osigurati zdravlje životinja prije puštanja u grad

- usklađuje i programira bilance materijalnih i medicinskih troškova za radnu jedinicu

- nadzire rad veterinarskih tehničara

- obavlja i druge poslove po nalogu ravnatelja operative i glavnog izvršnog direktora

- za svoj rad odgovoran je direktoru poslova i glavnom direktoru

3. Zvanje: Veterinarski tehničar

Broj pozicija: 1

Razina plaće: 7

Trajanje ugovora: probni rad 6 mjeseci, uz mogućnost produljenja.

Kvalifikacija:

- zadnja godina VSS - Veterinarski fakultet

- 1 godina određenog radnog iskustva u području djelatnosti centra

- izvrsne komunikacijske vještine

- sposobnost timskog rada

- poželjno znanje engleskog jezika

Radne dužnosti i odgovornosti:

- pomaže veterinaru u organizaciji rada u centru za liječenje pasa

- prima, upisuje i čisti životinje u centru

- usklađuje radnje s operativnim planom koji donosi veterinar

- cijepi i ubrizgava životinju

- pruža usluge skrbi i skrbi o postoperativnoj terapiji životinja

- predviđeno za stočnu hranu

- usklađuje i programira bilance materijalnih i medicinskih troškova za radnu jedinicu

- obavlja i druge poslove po nalogu nadređenog

- odgovara nadređenom za svoj rad

4. Naziv: Fizički radnik za hvatanje pasa

Broj pozicija: 1

Trajanje ugovora: probni rad 6 mjeseci, uz mogućnost produljenja.

Kvalifikacija:

- srednja škola

- vozačka dozvola B kategorije

Radne dužnosti i odgovornosti:

- prima upute od veterinaru i operativnog direktora

- obavlja usluge hvatanja pasa lualica i prijevoz istih u centar

- rasporediti životinje u kaveze i pobrinuti se za njihovu dobrobit

- obavlja i druge poslove na temelju djelatnosti poduzeća i naloga nadređenog,

- dužan je premjestiti iz postrojbe u druge postrojbe-područja, u posebnim slučajevima i prema potrebi rada po nalogu ravnatelja operative

- za svoj rad odgovara veterinaru, direktoru operative i glavnom direktoru

5. Zvanje: Održavač higijene

Broj pozicija: 1

Trajanje ugovora: probni rad 6 mjeseci, uz mogućnost produljenja.

Kvalifikacija:

- srednja škola

- 1 godina radnog iskustva

Razina plaće: 12

Radne dužnosti i odgovornosti:

- održava čistoću objekta centra;

- vodi cjelovit inventar;

- odgovara načelniku Centra za svoj rad

- čišćenje ureda i prostora općenito,

- čišćenje toaleta,

- čišćenje dvorišta i prostora oko objekta,

- obavlja i druge poslove koji se temelje na djelatnosti poduzeća i nalogima pretpostavljenog,

- za svoj rad odgovoran je voditelju Centra

Procedure konkursa

Zainteresirani kandidati mogu dobiti službeni obrazac u Arhivu poduzeća NPL "Hortikultura" SH.A ili ga preuzeti sa web stranice na adresi www.hortikultura-pr.com.

Dokumentacija se može dostaviti u fizičkom primjerku Arhivu na adresu ul. Tahir Zajmi, bb u Prištini ili putem Pošte Kosova.

Kandidati koji konkurišu dužni su uneti tacnu adresu, ugovorni broj telefona i e-mail adresu.

Samo odabrani kandidati bit će pozvani na daljnji postupak zapošljavanja.

Uz prijavu je potrebno priložiti:

- Prijavnica za NPL "Hortikultura"

- svjedodžbe o školskoj spremi

- dokaz o radnom iskustvu (izjava o mirovinskom povjerenju)

- presliku osobne iskaznice

- uvjerenje suda da nije osuđivan (ne starije od šest mjeseci)

Napomena: Prijave poslane poštom, koje nose poštanski žig na dostavi obavljenoj zadnjeg dana roka za podnošenje prijave, smatrat će se važećim i uzeti u obzir ako pristignu u roku od dva (2) dana. Prijave koje pristignu nakon navedenog roka i nepotpune s pripadajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Nepotpune prijave i dokumentacija prema uvjetima navedenim u ovom oglasu, kao i one koje pristignu nakon natječajnog roka, neće se razmatrati.

Oglas je otvoren od 22.06.2023 - 06.07.2023.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales




MEKA HALAL FOOD PASHTETË PULE

gluten
free



100% mish pule



cilësi e garantuar

pa konservues